

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5561
E martë, 28 gusht 2018
çmimi 0.40 €

Limaj në Shkup:
Shqiptarët nuk mund
t'i dominojë dhe
sundojë askush | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

KREJT
NJËJTË! F. 6



Ylber ÇITAKU

MINISTRJA HOXHA KËRKON
ANGAZHIM NË PROCESIN
INTEGRUES F. 6

LDK-ja THOTË SE NUK DO TA
LEJOJË THAÇIN TË BËJË
PAZARE ME TERRITORIN E
KOSOVËS F. 6

SOT MBAHET PROVIMI I
MATURËS, AFATI I GUSHTIT F. 8

EKONOMI

BASHKËPUNIMI EKONOMIK
RAJONAL, TEMË E TAKIMIT
TË KRYEMINISTRAVE F. 8

REÇICA TAKON TË RINJTË
NGA KOSOVA QË DO TË
AFTËSOHEN PROFESIONALISHT
NË GJERMANI F. 8

KULTURË

UNIFIKIMI I REDAKSIVE
NË FUNKSION TË
PËRMBAJTJEVE MEDIALE TË
KONVERGJUARA F.13

Shpresë MULLIQUI

SPORT

GERRARDI TRANSFERON
GREZDËN TE RANGERSI F. 18

LISTA E KOSOVËS PËR
NDESHJET E SHTATORIT F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", RRAHMAN JASHARAJ | FAQE 4

S'ka grevë, viti i ri shkollor nis më 3 shtator

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se tashmë janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit të ri shkollor. Ai ka bërë me dije se ky vit shkollor do të nisë më 3 shtator dhe nuk do të ketë greva. Megjithatë, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" Jasharaj ka paralajmëruar se në vazhdim të vitit shkollor sistemi arsimor mund të përballet me greva nëse institucionet shtetërore nuk i përfillin kërkesat e SBASHK-ut për njohjen e stazhit për vitet '90-ta dhe për nivelizimin e pagave. Ai ka thënë se punëtorët e arsimit nuk po kërkojnë asgjë më shumë sesa një vend meritore në Ligjin për pagat si dhe miratimin e Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e '90-ta

Asnjë veprim për korigjimin e vijës kufitare me Malin e Zi

FAQE 3



Kanë kaluar pesë muaj që nga ratifikimi i marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi dhe ende nuk është ndërmarë asnjë veprim në drejtim të korigjimit të vijës kufitare, siç parashihet me marrëveshje. Kryetari i Komisionit Shtetëror

për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, Shpejtim Bulliqi, ka deklaruar për "Epokën e re" se janë në pritje të veprimit të politikës, e cila, sipas tij, është përgjegjëse për hapjen e rinegociimit të marrëveshjes



Haradinaj: Duhet t'i respektojmë kufijtë që i kemi

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përsëritur të hënën në Durrës, në takimin e kryeministrave të rajonit, qëndrimin kundër korigjimit të kufijve. Në prani edhe të komisionarit të zgjerimit të Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, Haradinaj ka thënë se Kosova i ka kufijtë e vet të cilët duhen respektuar | FAQE 2

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Thaçi: Jam kundër kufijve etnikë, por nuk jam naiv

PRISHTINË, 27 GUSHT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se Kosova duhet ta mbyllë kapitullin e konfliktit me Serbinë në një formulë të përherëshme dhe të qëndrueshme. Ai në një intervistë për "EWB" ka thënë se anëtarësimi në BE dhe NATO, e cila është një dëshirë e 92 për qind e popullsisë së Kosovës, është e pakuptimtë derisa të zgjidhen çështjet e hapura bilaterale. "Kosova me Serbinë ka shumë çështje, nga trashëgimia e luftës, si të zhdukurit dhe reparacionet e

luftës, ndaj çështjeve më bashkëkohore. Disa nga këto çështje po trajtohen në dialog në Bruksel, por ka ardhur koha për zgjidhjen përfundimtare dhe ligjore. Unë jam kundër kufijve etnikë. Por, nuk jam edhe naiv. Unë e di se Serbia preferon t'i tërheqë këmbët në njohjen e pashmangshme të Kosovës. Ata do të dëshironin të ruanin status-quo, por ky harbim nuk është i mundur për të ruajtur më", ka deklaruar Thaçi, duke shtuar se duhet përcaktuar kufirin e gjatë

400 km midis Kosovës dhe Serbisë.

I pyetur nëse marrëveshja e re mbi korrigjimin e kufijve do të zëvendësojë marrëveshje të caktuara ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në dialogun në Bruksel, sidomos sa i përket formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, Thaçi ka theksuar se faktori për vonesat në këtë drejtim është Serbia. Thaçi ka folur edhe për liberalizimin e vizave, duke thënë se Kosova ka përm-bushur të gjitha kushtet, por tash



presin që Parlamenti Evropian dhe shtetet anëtare ta njohin përparimin dhe përkushtimin e madh të Kosovës.

Haradinaj: Duhet t'i respektojmë kufijtë që i kemi

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përsëritur të hënën në Durrës, në takimin e kryeministrave të rajonit, qëndrimin kundër korrigjimit të kufijve. Në prani edhe të komisionarit të zgjerimit të Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, Haradinaj ka thënë se Kosova i ka kufijtë e vet të cilët duhen respektuar



ka me Maqedoninë, i ka me Serbinë. Ne i respektojmë këta kufij dhe nuk mendojmë se duhet ndonjë kreativitet i ri për dizajnim të tyre, por duhet t'i respektojmë kufijtë që i kemi", ka thënë Haradinaj. Ndërsa komisionari i Zgjerimit të Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, i pyetur nga gazetarët lidhur me marrëveshjen përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ka pohuar se nuk është i gatshëm të komentojë. Por, ai ka përsëritur qëndrimin e Bashkimit Evropian se nuk do të pranohet asnjë vend i ri anëtar në BE pa zgjidhjen paraprake të kontesteve dhe mosmarrëveshjeve. "Nuk është e përshtatshme në këtë fazë të bëjmë komente lidhur me diskutimet dhe negociatat në vazhdim. Takimi javën e ardhshme në Bruksel (ndërmjet

presidentëve Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiq) nuk do të jetë takimi i fundit, do të jetë një tjetër takim dhe sigurisht do të kërkojnë kohë që të gjendet një marrëveshje", ka thënë Hahn. "Nuk jam i gatshëm të bëj asnjë koment, përveç atij siç është parashtruar në strategjinë tonë të Ballkanit Perëndimor, se ne nuk do të pranojmë asnjë anëtar të ri nëse nuk janë të zgjidhura mosmarrëveshjet dypalëshe",

ka theksuar Hahn, duke shtuar se ajo që ka vlerë për Bashkimin Evropian, është stabiliteti në rajon. "Duhet të kemi parasysh se çdo lloj marrëveshje dypalëshe nuk duhet ta rrezikojë stabilitetin e përgjithshëm të rajonit, por duhet të jetë e kundërta, duhet të kontribuojë për stabilitet në rajon", ka thënë Hahn.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë, Aleksandar Vuçiqi, në Forumin Evropian në Alpbach të Austrisë, të mbajtur në fundjavë, kanë folur së bashku për herë të parë se ndryshimi i kufijve është opsioni më real për arritje të marrëveshjes mes dy vendeve. Të dy presidentët pritet që më 7 shtator të takohen në Bruksel për ta vazhduar dialogun politik që po lehtësohet nga Bashkimi Evropian dhe Përfaqësuesja e Lartë, Federica Mogherini.

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, është shprehur në favor të ruajtjes së kufijve aktualë të Kosovës. Komentet Haradinaj i ka bërë të hënën në Durrës, ku ka marrë pjesë në takimin joformal të kryeministrave të Ballkanit Perëndimor dhe përfaqësuesve të Bashkimit Evropian. Ai ka përsëritur se nuk duhet një kreativitet i ri për dizajnim e kufijve dhe se duhet të respektohen kufijtë që janë. Çështja e korrigjimit të kufijve po lansohet si temë qendrore në marrëveshjen eventuale për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Po flitet shumë për kufijtë, por Kosova i ka kufijtë e vet. I ka me Shqipërinë, i ka me Malin e Zi, i

ka me Maqedoninë, i ka me Serbinë. Ne i respektojmë këta kufij dhe nuk mendojmë se duhet ndonjë kreativitet i ri për dizajnim të tyre, por duhet t'i respektojmë kufijtë që i kemi", ka thënë Haradinaj. Ndërsa komisionari i Zgjerimit të Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, i pyetur nga gazetarët lidhur me marrëveshjen përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ka pohuar se nuk është i gatshëm të komentojë. Por, ai ka përsëritur qëndrimin e Bashkimit Evropian se nuk do të pranohet asnjë vend i ri anëtar në BE pa zgjidhjen paraprake të kontesteve dhe mosmarrëveshjeve. "Nuk është e përshtatshme në këtë fazë të bëjmë komente lidhur me diskutimet dhe negociatat në vazhdim. Takimi javën e ardhshme në Bruksel (ndërmjet

Foggo: Jam i lumtur që dialogu Kosovë - Serbi po vazhdon

dhur ju. Demokraci ka në të dyja anët e kufirit, në Kosovë dhe Serbi, dhe ata janë zyrtarët tuaj të zgjedhur me votë të lirë dhe këta zyrtarë përfaqësojnë interesat e shumicës në të dy vendet", ka thënë Foggo gjatë një vizite në Komunën dhe Manastirin e Deçanit. "Unë jam i lumtur që dialogu është duke vazhduar dhe se presidenti Vuçiq dhe Thaçi po ashtu janë në dialog me Brukselin. Si ushtarakë që jemi, që prezantojmë NATO-n dhe KFOR-in, as unë dhe as gjen-

erali i KFOR-it, Cuoci, nuk jemi në dhomën kur mbahen këto negociata mes Thaçit dhe Vuçiqit", ka thënë ai.

Gjatë vizitës në Komunën e Deçanit, admiral Foggo ka thënë se janë pajtuar me kryetarin e komunës dhe zyrtarët e Kishës Ortodokse që punimet për ndërtimin e rrugëve në këtë komunë të bëhen sipas ligjit. Foggo ka kërkuar që për çdo projekt infrastrukturor të kihet parasysh Ligji për Zona të Veçanta të Mbrojtura.



Komisioni në pritje të politikës

Asnjë veprim për korrigjimin e vijës kufitare me Malin e Zi


Kanë kaluar pesë muaj që nga ratifikimi i marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi dhe ende nuk është ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të korrigjimit të vijës kufitare, siç parashihet me marrëveshje. Kryetari i Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, Shpejtim Bulliqi, ka deklaruar për "Epokën e re" se janë në pritje të veprimit të politikës, e cila, sipas tij, është përgjegjëse për hapjen e rinegocimit të marrëveshjes

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kryetari i Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, Shpejtim Bulliqi, ka bërë me dije se ende nuk është ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të korrigjimit të vijës kufitare, edhe pas pesë muajsh nga ratifikimi i marrëveshjes. Ai ka deklaruar se janë në pritje të Qeverisë për ta nisur rinegocimin e marrëveshjes, ashtu siç parashihet në deklaratën e nënshkruar nga dy presidentët. "Ne ende nuk kemi ndërmarrë diçka konkrete nga Qeveria. Faktikisht, ne i kemi bërë ato punë që dihen tashmë në këtë proces. Ne po presim tash që procesin e rinegocimit ta hapë politika, pra Qeveria. Ne si komision nuk e bëjmë hapjen e këtij procesi. Pa e marrë një veprim politik, ne nuk kemi mundësi të bëjmë diçka tjetër", ka thënë Bulliqi. Ai ka treguar se Komisioni që ai drejton është i gatshëm të fillojë me këtë proces. "Politika duhet t'i paraprijë procesit, pra ajo duhet ta hapë procesin e rinegocimit, tek pastaj komisioni profesional ulet në tavolinë dhe vazhdon punën që i takon", është shprehur ai. Bulliqi nuk ka treguar se kur mund të fillojë ky proces, por ka thënë se është në dijeni që Qeveria është e interesuar që sa më shpejt të fillojë procesi. "Ne nuk kemi ndonjë informatë konkrete për këtë çështje. E dimë se interesimi i tyre është ta nisnin këtë proces. Por, sigurisht se deri më tani ende nuk janë krijuar kushtet për të filluar procesi", ka thënë ai. Kryetari i Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror është shprehur i bindur se marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi është bërë gabim. Sipas tij, ka argumente të mjaftueshme që tregojnë se kanë ndodhur gabimet që janë bërë gjatë arritjes së marrëveshjes. "Ne po mos të kishim shpresuar se do të korrigjohet kufiri, sigurisht se nuk do të kishim arsye të mbetemi më tutje në këtë proces. Shpresojmë se në momentin që të krijohen

kushtet për t'u ulur në tavolinë të diskutimeve, sigurisht se kemi mjaft argumente për të treguar që demarkacioni në mes të Kosovës dhe Malit të Zi është bërë keq dhe duhet të korrigjohet", ka thënë ai. Ndër të tjera, Bulliqi ka deklaruar se deklarata e nënshkruar nga të dy presidentët i obligon të dy vendet ta rishikojnë këtë vijë kufitare. "Ne ende besojmë në marrëveshjen e dy presidentëve, sepse ata janë dy përfaqësuesit më të lartë të dy shteteve, të cilët kanë marrë për obligim të ulen dhe t'i rinegociojnë pikat kontestuese të kësaj marrëveshje", është shprehur ai. Ditë më parë edhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje ka kritikuar kryeministrin Haradinaj se nuk po ndërmerr asgjë në drejtim të korrigjimit të kësaj marrëveshje. "Saktësisht katër muaj më parë në Kuvendin e Kosovës u ratifikua marrëveshja e Vjenës për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, e cila ia mori vendit tonë 8 200 hektarë. Asokohe këmbëngulëm që kjo marrëveshje të korrigjohej para se të votohej, duke marrë parasysh dokumentacionin dhe hartat, faktet dhe opinionet shkencore të gjeografëve, historianëve dhe ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare, petitionin e mbi 205 mijë qytetarëve, demonstratat më të mëdha në Kosovën e pasluftës. Ky dikur ishte edhe qëndrimi i Haradinajt dhe i Limajt, para se të hynin në Qeveri", ka shkruar ai, duke shprehur skepticizëm se do të mund të ndodhë korrigjimi. "Por ata vendosën ta votojnë pa e korrigjuar marrëveshjen, sepse thanë se votimi do ta sillte liberalizimin e vizave. Gjithashtu, e garantuan popullin e Kosovës se do të bëhet korrigjimi i vijës kufitare me komision të përbashkët, pas ratifikimit. Katër muaj më vonë korrigjimi as nuk ka ndodhur e as nuk ka nisur. Çakorri e Zhlebi tash kanë mbetur përtej kufirit e Kosova u zvogëlua. Ndërsa liberalizimi i vizave u shndërrua në rekomandimin e radhës dhe mbetet çështje e një të ardhmeje të papërcaktuar. Korrigjimet kufitare, pasi që e ke ratifikuar një vijë të caktuar, funksionojnë




vetëm kur jep po aq sa merr, pra tit-for-tat, andaj Kosova tashmë nuk mund t'i marrë ata 8 200 hektarë", është shprehur Kurti. Marrëveshja e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi është nënshkruar në gusht të vitit 2015 në Vjenë, ndërsa Kuvendi i Kosovës e ka ratifikuar në mars

të këtij viti me 80 vota për, 11 kundër dhe asnjë abstenim. Kjo ishte bërë e mundshme pasi presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Malit të Zi, Filip Vujanović, kishin nënshkruar një aneks marrëveshje, në të cilën parashihej korrigjimi i vijës kufitare. Sipas kësaj mar-

rëveshje, do të formohet një trup i përbashkët punues për shënjimin e vijës kufitare. Gjithashtu, marrëveshja parasheh që Trupi i përbashkët punues në mënyrë specifike do t'i rishikojë dhe korrektojë sektorët në drejtim të Çakorrit dhe Kullës së Zhlebit.

Delawie takon Kusarin dhe Dedën, flasin për dialogun Kosovë - Serbi



PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Ambasadori i ShBA-së në Prishtinë, Greg Delawie, ka takuar të hënën udhëheqësit e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila dhe Ilir Deda, me të cilët ka biseduar për gjendjen aktuale politike në vend. Në profilin e vet në "Facebook", deputeti Ilir Deda ka shkruar se me ambasadorin amerikan kanë

biseduar për dialogun me Serbinë, sundimin e ligjit dhe rastin Blakaj. Ai ka treguar se në këtë takim me Delawien prezantuan qëndrimet e Alternativës për dialogun me Serbinë dhe kundërshtuan projektin e ndryshimit të kufijve. "Me ambasadorin Delawie biseduam edhe për sundim të ligjit dhe rastin Blakaj, dhe e

cekëm domosdoshmërinë e hetimit të pavarur e të pandikuar politik për këtë rast. Gjithashtu, e përsëritëm qëndrimin tonë që Kuvendi i Kosovës duhet ta ndërpresë pushimin sa më parë dhe ta jep fjalën e vet për zhvillimet e fundit negative për shtetësinë tonë", ka treguar deputeti Ilir Deda.

Flet për "Epokën e re", Rrahman Jasharaj

S'ka grevë, viti i ri shk



Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se tashmë janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit të ri shkollor. Ai ka bërë me dije se ky vit shkollor do të nisë më 3 shtator dhe nuk do të ketë greva. Megjithatë, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" Jasharaj ka paralajmëruar se në vazhdim të vitit shkollor sistemi arsimor mund të përballet me greva nëse institucionet shtetërore nuk i përfillin kërkesat e SBASHK-ut për njohjen e stazhit për vitet '90-ta dhe për nivelizimin e pagave. Ai ka thënë se punëtorët e arsimit nuk po kërkojnë asgjë më shumë sesa një vend meritator në Ligjin për pagat si dhe miratimin e Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e '90-ta

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, të hënën ka bërë me dije se viti i ri shkollor do të nisë më 3 shtator dhe nuk do të ketë greva. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka

thënë se tashmë janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e këtij viti shkollor. "Po, ky vit shkollor do të nisë më 3 shtator, pra nuk do të nis me greva. Nuk kemi shkuar që në fillim me greva ngaqë duam të shohim se sa e si janë sistemuar kolegët tanë, pra duhet të shohim se si qëndron puna me kolegët tanë sa iu takon normave dhe se a ka probleme me

normat dhe me plotësimin e tyre", ka deklaruar Jasharaj. Megjithatë, ai ka paralajmëruar se në vazhdim të vitit shkollor sistemi arsimor mund të përballet me greva nëse institucionet shtetërore nuk i përfillin kërkesat e SBASHK-ut për njohjen e stazhit për vitet '90-ta dhe për nivelizimin e pagave. Sipas Jasharajt, punëtorët e arsimit nuk po kërkojnë asgjë

më shumë sesa një vend meritator në Ligjin për pagat si dhe miratimin e Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e '90-ta që mundëson një pension të merituar e që është pak më i lartë se pensionet aktuale të punës dhe disa përfitime të tjera të mundshme. Pavarësisht prej gjendjes në vendin tonë, ai ka thënë se kërkesat e SBASHK-ut janë reale. Sipas tij, miratimi i Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e '90-ta është borxh moral për njerëzit që punuan në atë periudhë me plot sakrificë për ta mbajtur gjallë arsimin shqip. Jasharaj ka theksuar se SBASHK-u, përveç kërkesës për krijimin e kushteve më të mira

për mësimdhënësit, është duke u angazhuar në vazhdimësi edhe për ngritjen e cilësisë në arsim.

"Epoka e re": Z. Jasharaj, a janë bërë përgatitjet e nevojshme për fillimin e procesit mësimor në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës? Jasharaj: Lidhur me përgatitjet e duhura për fillimin e mbarë të vitit të ri shkollor raportet i kanë drejtoritë arsimore (DKA-të) që i kanë marrë nga drejtoritë e shkollave të komunave të tyre. Por, nga bisedat e para që kemi pasur me kryetarët e kuvendeve të sindikatave komunale të arsimit fillor e të mesëm nëpër komunat e Kosovës mund të them se në përgjithësi janë bërë përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit të ri shkollor.

Shkollor nis më 3 shtator

nuk do të thotë se në vazhdim të vitit shkollor do të jetë çdo gjë e qetë, por mund të ketë edhe greva.

"Epoka e re": Ju më herët keni paralajmëruar se do të ketë grevë në rast se nuk realizohen kërkesat e punonjësve të arsimit. Pse hoqët dorë nga greva?

Jasharaj: Jo, nuk kemi hequr dorë nga greva. Ne kemi paralajmëruar se sistemi arsimor do të përballet me greva nëse institucionet e shtetit nuk i përfillin kërkesat tona. Janë dy çështje kyçe që mund ta çojnë sistemin arsimor, edhe arsimin parauniversitar, edhe universitetet në greva. E para është Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e '90-ta. Ky projektligj u votua nga Qeveria Haradinaj dhe u votua edhe nga shumica e deputetëve shqiptarë në leximin e parë. Pas kësaj Komisioni Parlamentar për Arsimit hapëri debat publik për të ashtu siç e kërkojnë procedurat. Ne në SBASHK mendojmë se ky debat është stërzgatur, por na mbetet të besojmë se pas kthimit të deputetëve nga pushimet, Komisioni Parlamentar për Arsimit në kohën më të shkurtër të mundshme do ta dërgojë për miratim në leximin e dytë projektligjin bashkë me rekomandimet eventuale. Këtë besojmë do ta bëjnë jo për shkak të presioneve tona me greva, por në shenjë respekti për punëtorët e arsimit të viteve të '90-ta dhe sakrificës së tyre për mbrojtjen e arsimit shqip nga furtunat e pushtesit. Dhe çështja e dytë që mund ta dërgojë arsimin e Kosovës në grevë është nëse ministri Jagxhillar dhe institucionet nuk përfillin kundërshtimet e argumentuara të SBASHK-ut lidhur me Ligjin e pagave. Ne jemi takuar me ministrin Bytyqi dhe kemi kërkuar edhe angazhimin e tij në mënyrë që punëtorët e arsimit të Kosovës të kenë vend meritore në Ligjin për pagat. Versioni fillestar i Ministrisë së Administratës Publike (MAP) që drejton ministri Jagxhillar ka qenë degradues për punëtorët në arsim sepse i ka radhitur tepër poshtë në tabelën e gradimeve duke i krahasuar me profesionet për të cilat kërkohet vetëm arsimimi i mesëm. Ne kemi dhënë propozimet tona të argumentuara dhe nuk kërkojmë as më shumë e as më pak se të tjerët, por të jemi të radhitur njëjtë si të punësuarit në sektor të tjerë, bazuar në ngritjen akademike dhe në përgjegjësinë në punë. Të gjitha këto argumente ia kemi afruar ministrit Jagxhillar e, po ashtu, edhe koordinatorit nacional për reforma shtetërore Besnik Tahiri.

"Epoka e re": Keni marrë garanci prej Qeverisë se do të realizohet kërkesa juaj për pranim të stazhit për vitet '90-ta dhe për nivelizimin e pagave?

Jasharaj: Qeveria Haradinaj e ka vënë në rend dite Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e '90-ta dhe e ka votuar duke mundësuar kështu që ai të shkojë në Parlament. Duhet sqaruar se vitet e '90-ta janë të pranuar si vite kontributdhënëse për ata që punuan në arsim në këto vite dhe u numërohen dhe u ndihmojnë për të arritur kushtin që e ka caktuar Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, i cili kërkon që për ta gëzuar pensionin e plotë, personi duhet t'i ketë së paku 15 vjet përvojë të punës kontributdhënëse. Ligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e '90-ta të punëtorëve të arsimit të atyre viteve do t'u mundësojë që të gëzojnë një pension të merituar e që është pak më i lartë se pensionet aktuale të punës dhe disa përfitime të tjera të mundshme.

"Epoka e re": Nuk konsideroni se janë të larta kërkesat e SBASHK-ut duke pasur parasysh gjendjen në vendin tonë?

Jasharaj: Jo. Kërkesat e SBASHK-ut janë reale sepse në Ligjin për pagat nuk po kërkojmë as më shumë e as më pak sesa të punësuarit në sektorët e tjerë që kanë ngritje të njëjtë akademike me ne. Pra, po kërkojmë vend të merituar në këtë ligj dhe asgjë tjetër. Kurse sa i takon Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e '90-ta, e ka thënë edhe kryeministri, por edhe përfaqësues të tjerë të institucioneve, se është borxh moral për njerëzit që punuan me plot sakrificë në vitet e '90-ta duke mbajtur gjallë arsimin shqip dhe shpresat për lirinë e shtetit tonë.

"Epoka e re": Z. Jasharaj, SBASHK-u në vazhdimësi kërkon kushte më të mira për mësimdhënës si dhe rritje të pagave, por nuk ka rritje të cilësisë në arsim. A do ta ktheni vëmendjen te kjo çështje tash e tutje?

Jasharaj: Ne jemi sindikatë dhe si kudo në botë, edhe te ne sindikata në radhë të parë dhe me statutin e saj e ka angazhimin për realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Por, SBASHK-u që nga themelimi angazhimet i ka zhvilluar në dy fronte, pra në realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë dhe në ngritjen e

vazhdueshme të cilësisë në arsim. Ne kemi bërë veprime konkrete për këtë duke zhvilluar takime me mësimdhënës në çdo komunë e duke bashkëbiseduar për nevojën e angazhimeve të vazhdueshme për arsim edhe më të mirë. Kemi organizuar edhe konferenca me GIZ-in me tema kyçe pikërisht për angazhimet për ngritjen e cilësisë, por vazhdimisht edhe kemi kërkuar që shteti të investojë më shumë në arsim me qëllim që të përmirësohen kushtet e punës dhe të furnizohen shkollat me mjete të duhura të punës sepse ende në shumë shkolla të Kosovës mjete të vetme të punës janë shumësi, shpuza dhe dërrasa e zezë, shumica e të cilave janë shumë të vjetra dhe është vështirë edhe të shkruhet në to. Në shërbim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë kemi kërkuar që edhe trajnimet mos të jenë sa për t'u mbajtur, por të jenë në shërbim të ngritjes së vazhdueshme profesionale të mësimdhënësve. Kemi kërkuar, po ashtu, të krijohen kushte ligjore për pensionimin e punëtorëve arsimorë me sëmundje të rënda të cilëve do t'u jepeshin pensione të dinjitetshme dhe në vend të tyre do të angazhoheshin kadro të reja që, fatmirësisht, në Kosovë ka të tillë.

Thaçi i përgjigjet Kandidiqit: Kosova është shtet i të gjithë qytetarëve

PRISHTINE, 27 GUSHT (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se do të angazhohet për liri dhe siguri të lëvizjes për të gjithë qytetarët e Kosovës, përfshirë edhe komunitetin serb, kudo në Kosovë. Ai i bëri këto komente në përgjigje të letrës së humanistes serbe Natasha Kandidiq, e cila ka kërkuar nga Thaçi që personalisht të angazhohet për t'u mundësuar serbëve nga Gjakova që më 28 gusht ta vizitojnë kishën dhe shtëpitë e tyre dhe të mos u nënshtrohen, siç ka thënë ajo, poshtëtimeve sikurse vitin e kaluar. "Sot është e paimagjinueshme dhe është e papranueshme që dikush t'i cenojë të drejtat apo të mos lejojë vizitën e qytetarëve serbë në objektet fetare, qoftë në Gjakovë ose kudo tjetër anembanë Kosovës", ka thënë Thaçi në përgjigjen e tij të pub-



likuar në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se Kosova është shtet i të gjithë qytetarëve, pa dallim feje, kulture ose përkatësie etnike. "Jemi shteti më demokratik në

rajon dhe më gjerë, ku komunitetet etnike mbrohen me kushtetutë", ka thënë Thaçi. Ai i shprehu "mirënjohje të thellë" Kandidiqit për aktivitetin e saj para, gjatë dhe pas luftës.

"Epoka e re": Pra, nuk do të ketë grevë dhe më 3 shtator do të fillojë viti i ri shkollor?

Jasharaj: Po, ky vit shkollor do të nisë më 3 shtator, pra nuk do të nisë me greva. Nuk kemi shkuar që në fillim me greva ngaqë duam të shohim sesa e si janë sistematuar kolegët tanë, pra duhet të shohim se si qëndron puna me kolegët tanë sa iu takon normave dhe se a ka probleme me normat dhe me plotësimin e tyre. Po ashtu, nuk duam ta nisim vitin shkollor me greva sepse do të na kritikonin disa se po bëjmë greva për ta vazhduar pushimin. Aq më shumë nga kjo nuk duam t'ua mohojmë gëzimin nxënësve, të cilët të gëzuar presin fillimin e vitit të ri shkollor për t'u takuar me shokë e shoqe dhe me mësuesit e mësimdhënësit e tyre pas pushimit veror. Mirëpo kjo

Vetëvritet një i paraburgosur në Dubravë

DUBRAVË, 27 GUSHT (ER) - Në Qendrën Korrektuese në Dubravë u vetëvra të hënën një i paraburgosur me inicialet I. K., i lindur më 22. 11. 1987, nga fshati Tërpezë, Komuna e Malishevës. Në një komunikatë për media të Shërbimit Korrektues të Kosovës, thuhet se "i paraburgosur

suri I. K. ishte arrestuar më 10. 4. 2018 dhe ishte pranuar në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, ndërsa në Qendrën Korrektuese në Dubravë ishte transferuar më 3. 7. 2018". "Vepra me të cilën ngarkohej ishte vrasje e rëndë në tentativë dhe kishte vazhdim të

paraburgimit deri më 8. 9. 2018", thuhet në njoftim. Sipas të njëjtut, ai ka qenë i hospitalizuar për një periudhë në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës. Për rastin e vetëvrasjes bëhet me dije se janë njoftuar Prokuroria, Gjykata, Policia e Kosovës si dhe familja e të ndjerit.



LDK-ja thotë se nuk do ta lejojë Thaçin të bëjë pazare me territorin e Kosovës

PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije të hënën se nuk do t'i lejojë Thaçin dhe Vuçiqin të bëjnë pazare me territorin e Kosovës. "Kosova është një dhe e pandashme. Territori i Kosovës nuk mund të nxirret në pazar. Presidenti Thaçi duhet të

ndalet", është thënë në komunikatën e kësaj partie. Sipas LDK-së, presidenti Thaçi nuk ka mandat kushtetues për veprime të tilla. "Negociatat për territorin e Kosovës janë kundërkushtetuese dhe kushdo që hyn në lojëra të tilla do t'i bartë pasojat kushtetuese dhe politike. Ne do t'i bashkërendojmë veprimet në Kuvend për ta

penguar vënien në pikëpyetje të sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës nga presidenti i vendit", është theksuar më tutje në këtë komunikatë. LDK-ja ka paralajmëruar se do të refuzojë çdo marrëveshje që bëhet pa mandat të Kuvendit dhe papajtueshmëri të gjerë të forcave relevante politike dhe të qytetarëve.



Ministrja Hoxha kërkon angazhim në procesin integruar




PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Ministrja e Integritetit Evropian, Dhurata Hoxha, në takime të ndara ka pritur të hënën ministrin e Drejtësisë, Abelard Tahirin, dhe ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Bajram

Hasanin, me të cilët ka diskutuar për zbatimin e planit kombëtar për MSA-në dhe Agjendën Evropiane të Reformave. Në takime ministrja Hoxha ka theksuar se zbatimi i MSA-së mbetet prioritet për çdo sektor

dhe se çdo institucion duhet të angazhohet më shumë në këtë drejtim. "Në takime të ndara përgëzova ministrin Tahiri dhe Hasani për angazhimin maksimal për zbatimin e reformave, duke përbushur zotimet dhe

prioritetet tona, fuqizimin e sundimit të ligjit dhe masave që i kontribuojnë zbatimit të MSA-së si dhe kërkova më shumë angazhim për pjesën e mbetur të vitit", ka theksuar ministrja Hoxha. Të gjithë min-

istrat u pajtuan se zbatimi i MSA-së është prioriteti kryesor dhe u zotuan për angazhim sa më të madh në nivel qendror, duke zbatuar masat në pajtim me zotimet dhe afatet e këtij plani.



Artan Dërmaku i bashkohet Lëvizjes Vetëvendosje

PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Prof. dr. Artan Dërmaku është anëtarësuar sot në Lëvizjen Vetëvendosje. Kryetari i kësaj lëvizje, Albin Kurti, ka pritur në takim Dërmakun për të cilin ka thënë se janë të njëjtës gjeneratë. "Kemi studiuar bashkë në Fakultetin e Elektroteknikës. Tash do të jemi sërish bashkë në Lëvizje. Prof. dr. Artan Dërmaku sot u anëtarësua në Vetëvendosje.

Shkollën fillore dhe të mesme i ka kryer në Prishtinë, kurse studimet universitare në Universitetin Teknik të Vjenës (TU Wien) në Austri, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike. Është fitues i çmimit ndërkombëtar 'Fred Margulies Preis 2012' i cili u jepet shkencëtarëve më të mirë në Austri. Ka punuar dy vjet në kompaninë 'Siemens', pastaj

hulumtues shkencor në Universitetin Teknik të Vjenës dhe si mësimdhënës në universitete publike e kolegje private në Kosovë. Më shumë shkencë e shkencëtarë në lëvizjen tonë politike do të përkthehet në më shumë konsistencë dhe dije në politikën e Kosovës", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".



Limaj në Shkup: Shqiptarët nuk mund t'i dominojnë dhe sundojnë askush

"Epoka e re"

SHKUP, 27 GUSHT - Zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh kryetar i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka marrë pjesë në akademinë përkujtimore të organizuar në Shkup, kushtuar 20-vjetorit të rënies së heroit Ismet Jashari - komandant "Kumanova". Me këtë rast, Limaj ka thënë se 20 vjet më parë kombi shqiptar ishte në një udhëkryq kritik, në një moment ku do ta përcaktonte rrënimin përfundimtar apo ringjalljen. "Një Shqipëri e dërrmuar, një Shqipëri e trazuar, Kosova e ndezur në flakë, shqiptarët në Luginë e Maqedoni pa asnjë të drejtë. Pak a shumë kjo ishte piktura e kombit shqiptar para 20 vjetëve. Duke iu falënderuar angazhimit të qindra veprimtarëve, kombi shqiptar kishte arritur në stadin më të lartë të pjekurisë politike. Përballë kishte armikun i cili nuk e njihje gjuhën e njohjes së të drejtave të tjera, prandaj shqiptarët ishin pjekur deri në atë shkallë sa qenë të gatshëm t'i kapin armët për të luftuar", ka thënë Limaj të hënën në Shkup. Më tutje, Limaj ka thënë se kushtimi i komandantit legjendar Adem Jashari u lëshua në çdo cep ku jetonin shqiptarët dhe kjo ndodhi edhe në Maqedoni. "Këtu ku jemi ne sot nuk ka qenë e lehtë. Apeli im është të mos habiteni nga zhvillimet ditore



dhe mos e përzini në asnjë mënyrë e mos lejoni në asnjë mënyrë ta ngatërroni luftën çlirimtare me angazhimet ditore. Ne besojmë se kemi arritur të bëjmë një kthesë të jashtëzakonshme dhe kjo duhet njohur e vlerësuar", ka shtuar Limaj. Kombi shqiptar, sipas Limajt, nuk ka

qenë asnjëherë më mirë sesa është sot. Megjithatë, ai ka thënë se duhet të punojnë për ta forcuar pozicionin në rajon. Gara për t'i dominuar dhe sunduar të tjerët, Limaj ka thënë se është garë e humbur. Me shqiptarët mund të bashkëjetojë por, sipas tij, askush nuk mund t'i

dominojë dhe sundojë. "Emri i Kumanovës nuk ka qenë i rastësishëm. Kemi dashur të tregojmë që në luftën e Kosovës po marrin pjesë të gjitha trevat ku janë shqiptarët. Kosova është e të gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë. Ne që kemi kaluar në atë kohë e dimë mirë çfarë kanë bërë

shqiptarët që jetojnë në Maqedoni e në Luginë të Preshevës edhe në kohën kur në Kosovë kishte dilema se a ka apo s'ka UÇK", ka theksuar Limaj. Ndryshe, të shtunën në Kleçkë është shënuar 20-vjetori i rënies së 67 dëshmorëve të Brigadës "121 Kumanova".

Sot mbahet provimi i maturës, afati i gushtit

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, sot (e martë) do t'i vizitojë nxënësit gjatë mbajtjes së testit të Maturës Shtetërore 2018 (afati i gushtit) në Gjimnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë. Për mbarëvajtjen e këtij testi MASHT-i ka angazhuar dhe trajnuar 93 komisionarë. Gjithashtu, janë caktuar edhe 630 administratorë dhe 105 mbikëqyrës



mbarëvajtjen e testit të maturës, duke shtuar se dëshiron të ketë rezultate reale dhe të besueshme. Në këtë takim u tha se nxënësve nuk do t'u lejohet hyrja me telefon në Qendrën e Testimit, ndërsa prindërve u

është bërë thirrje të mos lejojnë fëmijët të marrin celularë, pasi do të përjashtohen nga testi edhe nëse nuk i përdorin. Celularët nuk do të lejohen të përdoren as nga administratorët.

Për mbarëvajtjen e këtij testi, MASHT-i ka angazhuar dhe trajnuar 93 komisionarë. Gjithashtu, janë caktuar edhe 630 administratorë dhe 105 mbikëqyrës. Provimin e kanë paraqitur 7 896 kandidatë.

EPOKA E RE **Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 27 GUSHT - Maturantët e mbetur për afatin e dytë të maturës do t'i nënshtrohen sot (e martë) provimit në orën 10:00 (pjesa e parë) dhe më 1 shtator (pjesa e dytë). Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, të martën do t'i vizitojë nxënësit gjatë mbajtjes së testit të Maturës Shtetërore 2018 (afati i gushtit) në Gjimnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë. Në takimin me komisionarët e

testit të Maturës Shtetërore 2018, të organizuar nga Komisioni i Shtetëror i Maturës, ministri Bytyqi ka pohuar se tashmë janë bërë përgatitjet e duhura për mbajtjen e testit të maturës. Ai ka kërkuar nga komisionarët e pranishëm t'i zvogëlojnë lëshimet eventuale që kanë ndodhur në afatin e parë të provimit. Ministri Bytyqi ka theksuar nevojën e respektimit me rigorozitet të akteve ligjore, vendimit dhe udhëzimit administrativ lidhur me

Lekaj: 2018-a, vit i zhvillimit të infrastrukturës

PRISHTINË, 27 GUSHT - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, së bashku me kryetarin e Komunes së Deçanit, Bashkim Ramosaj, kanë takuar të hënën komandantin e forcave të përbashkëta të NATO-s, admiralin James Foggo dhe komandantin e KFOR-it, Salvatore

Cuoci, me të cilët kanë diskutuar për gjendjen e përgjithshme të sigurisë dhe për lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Ministri Lekaj në këtë takim ka thënë se viti 2018 është vit i zhvillimit të infrastrukturës, i cili do t'i ndihmojë në zhvillimin ekonomik.

Ministri Lekaj ka përsëritur qëndrimin e vet se trashëgimia kulturore në Kosovë do të mbrohet gjithmonë. Kurse admiralin Foggo i ka ofruar ndihmën e pakursyer ministrit Lekaj për çfarëdo gjëje që ka nevojë dhe e ka falënderuar për sqarimet e detajuara që projekti i

rrugës Deçan - kufiri me Malin e Zi, është duke u zhvilluar në të mirë të qytetarëve pa dëmtuar askënd. Pas takimit është mbajtur një konferencë për medie ku, pos të tjerash, ministri Lekaj ka pohuar se zhvillimi infrastrukturor ka impakt pozitiv edhe për zhvillimin e tur-

izmit në zonat malore. Admirali Foggo, duke folur për rëndësinë e zhvillimit ekonomik, ka thënë se me këtë ritëm të zhvillimit dhe me këtë dinamikë të punëve nga të gjithë sa ka parë ai, zhvillimi ekonomik nuk do të jetë i largët për Kosovën.



Posta e Kosovës kërkon nga Qeveria ta shlyejë borxhin prej pesë milionë eurosh

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 GUSHT - Menaxhmenti i Postës së Kosovës përmes një komunikate për media ka njoftuar se javën e kaluar me një shkresë i është drejtuar Qeverisë së Kosovës që, në përputhje me ligjin, ta shlyejë sa më shpejt borxhin në vlerë prej pesë milionë eurosh. "Ky borxh është krijuar për shkak se Qeveria nuk ka rimbursuar humbjet që ka pësuar posta gjatë ofrimit të shërbimit universal postar nga viti 2013 e deri më sot. Këtë shërbim posta është e obliguar ta kryejë në tërë territorin e Kosovës, pavarësisht prej humbjeve, ndërkaq Qeveria është e obliguar me ligj t'i mbulojë humbjet financiare. Gjatë ofrimit të këtij shërbimi, Posta e Kosovës ka krijuar më shumë shpenzime sesa të hyra për shkak të tarifave të ulëta për t'i dërguar dërgesat. Letra e thjeshtë për 0.40 euro duhet të dërgohet në fshatrat më të thella të Kosovës. Mbulimin e humbjeve prej

4,947,097.18 eurosh ndërmarrja publike Posta e Kosovës është duke e kërkuar nga Qeveria për vite me radhë", thuhet në komunikatën e Postës së Kosovës.

Më tej, përmes kësaj komunikate menaxhmenti i Postës së Kosovës ka njoftuar se humbjet financiare në shërbimin universal postar janë konfirmuar edhe nga organe kompetente siç janë përmbartuesi privat, Gjykata Themelore në Prishtinë, Auditori i Jashtëm si dhe ARKEP (Autoriteti Rregullativ i Komunikimit Elektronik dhe Postar). "Mosmbulimi i këtij shërbimi do ta vë Postën e Kosovës në situatë të papërbalueshme financiare, ku nuk do të mund të bëhet ekzekutimi i pagave për punonjësit si një obligim ligjor, si dhe do të shkaktojë probleme serioze edhe në operimin normal të ndërmarrjes. Posta ka kërkuar nga Qeveria që brenda muajit gusht ta shlyejë borxhin ndaj Postës sepse nuk ekziston asnjë arsye për zvarritje të mëtejme", është theksuar në komunikatën e Postës së Kosovës.



Bashkëpunimi ekonomik rajonal, temë e takimit të kryeministrave



Tre kryeministra nga vendet e Ballkanit Perëndimor, ai i Bullgarisë, i Serbisë dhe i Malit të Zi, nuk kanë marrë pjesë të hënën në takim joformal të organizuar nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në Durrës. Ky i fundit ka theksuar se me kryeministrat e tjerë është zhvilluar një takim i frytshëm, nga i cili kanë bërë një bilanc të ecurisë së procesit të krijimit të zonës rajonale ekonomike dhe të ecurisë së përbashkët në rrugën e anëtarësimit në BE

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

DURRËS, 27 GUSHT - Në Durrës të hënën është mbajtur takimi i kryeministrave të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në takim është i pranishëm edhe komisionari për Zgjerim, Johannes Hahn. Kryeministrat e vendeve të Ballkanit Perëndimor në takimin joformal kanë diskutuar për thellimin e integritetit rajonal, me fokus në ekonomi, tregti dhe energjetikë. Ata kanë theksuar se është e rëndësishme ta promovojnë rajonin në nivel global si një brend, duke theksuar domosdoshmërinë e rritjes së partneritetit rajonal dhe veprimet e shteteve rreth lehtësisht të lëvizjes ndërkufitare të mallrave si dhe transportit. Pas takimit, kryeministrat dolën në një konferencë të përbashkët për media, në të cilat dhanë detaje nga çështjet e diskutuara. "Kemi zhvilluar një takim të frytshëm. Duke bërë një bilanc të ecurisë së procesit të krijimit të zonës rajonale ekonomike, duke parë me radhë të gjitha aspektet e një procesi qoftë ato që kanë ecur si duhet, qoftë ato që kanë nevojë për një shtytje më të fortë. Patjetër kemi diskutuar edhe më gjerësisht për marrëdhëniet dhe ecurinë e përbashkët në rrugën e anëtarësimit në BE", ka thënë Rama. Ai ka treguar edhe arsyet e mungesës së disa homologëve. "Kushtet objektive kanë pamundësuar praninë e disa miqve të tjerë. I shpreh ngushëllimet tona kryeministrit Borisov për aksidentin tragjik ku humbën jetën shumë persona dhe është bërë shkak për anulimin në min-

utën e fundit të ardhjes së tij. Po ashtu, kryeministri i Maqedonisë e ka pasur të pamundur fluturimin për shkak të kohës, ndërkaq edhe kryeministria e Serbisë na përcolli keqardhjen për pamundësinë e pjesëmarrjes", ka thënë Rama. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova ka krijuar stimuj të fuqishëm për ndërlidhje në të gjitha fushat me rajonin. "Në agjendën tonë të konektivitetit, kemi planifikuar dhe financuar projekte të shumta që do të na lidhin me të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe vendet evropiane. Ne po ndihmojmë njësimin ekonomik, për një treg dhe rajon për investim të vendeve të Ballkanit Perëndimor", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se deri në vitin 2022 kanë paraparë përmbylljen e infrastrukturës rrugore. "Jemi në proces të kyçjes në roaming, kemi lansuar agjendën e digitalizimit dhe jemi në proces të përbashkës së të gjitha marrëveshjeve për menaxhimin e integruar të kufijve", është ka thënë Haradinaj. Kryeministri Haradinaj ka treguar se në takimin joformal të kryeministrave të Ballkanit Perëndimor në Durrës kanë diskutuar edhe për dinamikën e përbashkët në rrugën e anëtarësimit evropian, me ç'rast

ai ka theksuar se gjashtëshja e ka rastin ideal, të punojë për integritet të fuqishme rajonale dhe të përafrohet me BE-në. Komisionari për Zgjerim, Johannes Hahn, përmes një mesazhi në llogarinë e vet në "Twitter" ka shkruar se ky takim i shërben bashkëpunimit ekonomik dhe marrëdhënive mes vendeve të rajonit. "Takimi në Durrës, pjesë e dinamikës pozitive. Rajoni do ta nxisë rritjen ekonomike, vendet e punës dhe prosperitetin, rajonin përgjatë rrugës për anëtarësimin në BE", ka shkruar Hahn.

ai ka theksuar se gjashtëshja e ka rastin ideal, të punojë për integritet të fuqishme rajonale dhe të përafrohet me BE-në. Komisionari për Zgjerim, Johannes Hahn, përmes një mesazhi në llogarinë e vet në "Twitter" ka shkruar se ky takim i shërben bashkëpunimit ekonomik dhe marrëdhënive mes vendeve të rajonit. "Takimi në Durrës, pjesë e dinamikës pozitive. Rajoni do ta nxisë rritjen ekonomike, vendet e punës dhe prosperitetin, rajonin përgjatë rrugës për anëtarësimin në BE", ka shkruar Hahn.

Vitin e ardhshëm Kosova do të përfitojë 120 milionë euro nga BERZh-i

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në margjina të takimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të hënën në Durrës ka zhvilluar takim me presidentin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), Suma Chakrabarti. Me këtë rast kryeministri Haradinaj ka falënderuar presidentin Chakrabarti për përkrahjen e projekteve zhvillimore për Kosovën dhe projekteve në kuadër të Integritetit Ekonomik Rajonal, të financuara nga ana e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, që Kosovës i siguron perspektivë të qartë integruese në

strukturat e Bashkimit Evropian. Gjatë këtij takimi kryeministri Haradinaj është njoftuar nga presidenti Chakrabarti se në vitin e ardhshëm fondet për Kosovën, nga 70 milionë do të rriten në 120 milionë euro dhe do të fillojë realizimi i unazës së Prishtinës dhe projekte të tjera infrastrukturore të prezantuara në shkurt në Samitin e Londrës që kanë të bëjnë me infrastrukturën e qyteteve të tjera të Kosovës. Presidenti i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Suma Chakrabarti, duke vlerësuar progresin e Kosovës, ka thënë se BERZh-i do ta vazhdojë mbështetjen e projekteve të cilat ndihmojnë zhvillimin ekonomik të vendit.

Reçica takon të rinjtë nga Kosova që do të aftësohen profesionalisht në Gjermani

PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, ka pritur në takim një grup të rinjsh nga Kosova të cilët janë përzgjedhur për arsim dhe aftësim profesional në Gjermani, në kuadër të programit 'Ausbildungsininitiative 2018' në

mes të MPMS-së dhe GIZ-it gjerman, i cili po implementohet në bashkëpunim me Shoqatën e Ndërtuesve Bavarez në Gjermani. Gjashtë studentët e grupit të parë do të udhëtojnë sot në Gjermani, ndërkaq nëntë të tjerë do të udhëtojnë në tetor të këtij viti.

Ministri Reçica ka përgëzuar studentët për mundësinë që u është dhënë duke thënë se MPMS-ja, së bashku me shtetin gjerman nëpërmjet organizatës GIZ do të bashkëpunojë në programe të ngjashme, duke zgjedhur mundësitë që të rinjtë tanë të aftësohen në fusha të

ndryshme. "Të rinjtë janë pasqyra e shtetit tonë. Aftësitë që do t'i përfitoni në Gjermani uroj që t'i ktheni në praktikë pasi të ktheheni në Kosovë. Vendi ynë ka nevojë për të rinj të aftësuar profesionalisht, të cilët i kontribuojnë vendit, duke u shndërruar në shembull edhe për gjeneratat e

tjera", ka deklaruar Reçica. Studentët falënderuan ministrin për pritjen dhe përkrahjen duke thënë se aftësitë të cilat do t'i përfitojnë gjatë qëndrimit në Gjermani do t'i shfrytëzojnë për t'i shërbyer vendit pasi të kthehen në Kosovë, në mënyrë që të kontribuojnë në rritjen e mirëqenies sociale.

Begaj kërkon të përshpejtohet realizimi i projekteve kapitale

MITROVICË, 27 GUSHT - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve. Në këtë mbledhje, në mesin e shumë çështjeve dhe raportimeve, u fol edhe për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, si dhe për realizimin e projekteve kapitale dhe planifikimeve

komunale. Kryetari Begaj ka kërkuar nga drejtoritë përkatëse që të përshpejtohet realizimi i projekteve kapitale. "Jemi në muajt e fundit të vitit dhe projektet infrastrukturore mund të shënojnë ngecje për shkak të reshjeve", ka thënë Begaj. Në këtë mbledhje drejtori i

Arsimit, Blerim Thaçi, ka bërë me dije se janë duke u bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, në të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës. Ai ka thënë se disa prej objekteve shkollore janë duke vazhduar meremetimet e domosdoshme të cilat pritet të përfundojnë deri në fillimin e vitit shkollor.



MMPH-ja ndan 25 mijë euro për rehabilitimin e deponisë në Sharr

DRAGASH, 27 GUSHT (ER) - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, së bashku me kryetarin e Komunës së Dragashit, Shaban Shabani, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e projektit "Modernizimi dhe zgjerimi i deponisë së mbeturinave në Sharr", i cili ka vlerën prej 25 mijë eurosh në vitin fiskal 2018 dhe që financohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Gjatë ceremonisë ministri Matoshi ka thënë se MMPH-ja ka një qasje të veçantë për Komunën e Dragashit për shkak të parkut nacional Sharr andaj, sipas tij, ky investim ka për qëllim rehabilitimin e deponisë së mbeturinave në Sharr. "Kam kënaqësi që sot kam nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me kryetarin e Komunës së

Dragashit, Shaban Shabani. Gjysmën e territorit të kësaj komune e përbën parkun nacional Sharr, andaj kjo na motivon që MMPH-ja të përkrahë këtë komunë me projekte të ndryshme. Ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen", ka thënë Matoshi.

Ai ka shtuar se marrëveshja për rehabilitimin e deponisë në parkun nacional Sharr po bëhet në prag të fillimit të fushatës tremujore për pastrimin e vendit. "Nënshkrimi i marrëveshjes për rehabilitimin e deponisë së mbeturinave në Sharr po bëhet pak ditë para fillimit të fushatës 'Ta pastrojmë Kosovën'. Ne u pajtuam që Komuna e Dragashit të jetë e angazhuar në këtë aksion", ka deklaruar Matoshi.

Ndërsa kryetari i Komunës së Dragashit, Shaban Shabani, ka falënderuar ministrin Matoshi duke vlerësuar kështu projektin



"Modernizimi dhe zgjerimi i deponisë së mbeturinave në Sharr" si të domosdoshëm për komunën që ai drejton. "Ky

projekt është i veçantë sepse ne pretendojmë të jemi si komunë turistike meqë e kemi parkun nacional Sharr. Këto investime

dhe investimet e tjera që janë në vazhdimësi, besoj fuqishëm se do të bëjnë një komunë pa mbeturina", ka thënë Shabani.

Prizrenasit të shqetësuar nga qentë endacakë



PRIZREN, 27 GUSHT (ER) - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se prej raportimeve nga qendra e thirrjeve "Alo, Komuna!", qentë endacakë janë shqetësim i madh për qytetarët e kësaj komune. "Shqetësimet kryesisht kanë të bëjnë me mundësinë e bartjes së sëmundjeve të ndryshme dhe agresivitetin e këtyre qenve ndaj kalimtarëve. Komuna tashmë ka ndërmarrë disa hapa rreth kësaj problematike, por ky problem nuk mund të zgjidhet menjëherë. Disa qytetarëve, që sugjerojnë eliminimin e këtyre qenve, duhet t'ua përkujtojmë se ky veprim, pos që është johuman, është i ndaluar edhe me ligj. Pra,

nuk ekziston 'shkopi magjik' për ta zgjidhur problemin e grumbulluar ndër vite. Problemi i qenve endacakë është problem në shkallë vendi. Komuna edhe po t'i largonte këto krijesa nga rrugët e qytetit, vendin e tyre shumë shpejt do ta zinin qentë nga qytetet e tjera të vendit", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.

Kjo komunë ka bërë me dije se, sipas procedurave të lejuara, qentë endacakë kapen, trajtohen, sterilizohen, socializohen me ambientin e ri. Dhe, nëse konstatohet se mund të lirohen, ata lëshohen në vendin ku janë zënë. "Në rastet kur qentë kanë sëmundje të

pashërueshme dhe tregojnë agresivitet nuk përjashtohet eutanazia. Këto hapa i ka ndërmarrë komuna nga muaji i kaluar. Pos kësaj, komuna ka pranuar ta ndërtojë qendrën për trajtimin e përkohshëm të këtyre qenve, ta bëjë regjistrimin e qenve që kanë pronarë, si dhe ta bëjë edukimin e duhur të pronarëve të tyre. Këta janë hapat e nevojshëm për menaxhimin e qenve endacakë në Prizren. Për t'i arritur këto qëllime, Komuna e Prizrenit do të jetë në bashkëpunim me katër organizatat që merren me mbrojtjen e kafshëve", është thënë në këtë njoftimin e Komunës së Prizrenit.

KEDS-i investon fuqishëm në fshatrat e Suharekës

SUHAREKË, 27 GUSHT - Fshatrat Gjinoc, Leshan, Sallagrazhdë dhe Mushtisht të Suharekës janë përfitues nga largpërçuesi 10 kV që ka ndërtuar KEDS-i, ndërsa nga rrejtji 0.4 kV kanë përfituar 61 familje të fshatit Leshan. KEDS-i ka investuar në rjetin e ri të tensionit të lartë dhe atij të ulët në tri fshatra të Suharekës. "Në kuadër të projektit

është instaluar një stabiliment shpërndarës krejtësisht i ri dhe mjaft i nevojshëm për banorët dhe bizneset, ka përmirësuar dukshëm rjetin energjetik dhe kapacitetin bartës. Por ajo që më së që shumti vlen të theksohet është rritja e sigurisë për banorët", është bërë me dije në njoftimin e KEDS-it. Gjithashtu, në kuadër të

këtij projekti në të ardhmen parashihet të ndahen linjat, të bëhen të veçanta për amvisërinë dhe për biznesat, që do t'ua lehtësojë shumë punën. Shtyllat e vjetra që kanë qenë të vendosura nëpër oborre dhe nëpër arra tani kanë kaluar skaj rrugës, që mundëson stabilitet energjetik dhe siguri për të gjithë.



Krejt njëjtë!

Komandantë të UÇK-së, deputetë e qeveritarë, kryetarë partish politike, kryetarë komunash, gazetarë, prokurorë gjykatës, qytetarë...!



YLBER ÇITAKU

Fitimi i lirisë në vitin 1999 qytetarit të Kosovës i mjaftoj që të marrë frymë lirshëm. Kjo nuk ishte pak, përkundrazi largimi i dhunës së shfrenuar të shovinizmit serb mbi popullatën autoktone të Kosovës ishte një nga të arriturat më të mëdha të njerëzimit pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo lehtë dëshmohej edhe me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të vendeve më demokratike të botës për lirinë e popullit dhe territorit të Kosovës nga regjimi serb, i cili dirigjohet nga Akademia e Shkencave në Beograd, e ku për udhëheqës e kishte vënë kasapin e Ballkanit, Slobodan Millosheviqin, i cili paraprakisht nxiti, filloi dhe komandoi luftërat në Slloveni, Kroaci dhe Bosnje.

Në qershorin e vitit 1999 populli liridashës i Kosovës, ushtarët e UÇK-së dhe ata të NATO-s i prit me një admirim të paparë, sigurisht që këtë admirim ushtarët e meritonin, në veçanti komandantët e UÇK-së, edhe për faktin se përgjegjësitë që ata kishin marrë gjatë luftës ishin mbinjerëzore, përgjegjësi këto që në kushte dhe rrethana normale pak njerëz do t'i merrnin, e kur kësaj t'i shtohet se këto detyra dhe përgjegjësi u kurorëzuan me çlirimin e vendit, atëherë është krejt normale që admirimi për ta të ishte i papërshkrueshëm.

Ushtarët e vijës së parë të luftës së UÇK-së me dinjitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi kombëtare (me përjashtim të ndonjë rasti të izoluar) pritën ushtarët e KFOR-it, popullsinë e zhvendosur në male si dhe popullatën e dëbuar jashtë territorit të Kosovës.

Ushtarët njëjtë vepruan edhe me rastin e demobilizimit, vepruan ashtu siç u pajtuan eprorët e UÇK-së dhe ata të KFOR-it, ushtarët e vijës së parë të luftës në Kosovë iu kthyen jetës së zakonshme dhe profesionit që kishin para se ta vishnin uniformën e shenjtë të ushtarit të lirisë, filluan meremetimin dhe rindërtimin e shtëpive të tyre të djegura e të shkatërruara. Disa prej tyre u angazhuan në shoqata humanitare, disa u kyçën në institucionet që po krijoheshin si TMK-ja e Policia e Kosovës, një pjesë e tyre

merreshin me bujqësi e një pjesë e tyre me vetëshërimin e plagëve dhe vetërehabilitim nga traumat e luftës.

Ushtarët e vijës së parë të luftës së UÇK-së (përjashtoj ndonjë rast të izoluar) ishin në nivel të qytetarisë, pra merituan dhe meritojnë respekt dhe trajtim prej luftëtarëve të lirisë, këta djem dhe vajza, burra e gra nuk kanë merituar një trajtim çfarë po iu bënë sot shoqëria e Kosovës. Një shoqëri e Kosovës që sillet në mënyrë prej diletantëve e deri te sjellja kriminale ndaj kësaj kategorie, në këto sjellje hyjnë komandantët e UÇK-së, deputetë e qeveritarë, liderë të partive politike, gazetarë, prokurorë e gjykatës.

Këto grupe me sjellje diletante e kriminale pa një pajtim paraprak, pra rastësisht, por krejt në mënyrë të përkryer kanë punuar kundër interesave të ushtarëve të vijës së parë të UÇK-së, kundër interesave të qytetarëve dhe të vendit në përgjithësi.

Të qenurit i uniformuar nën uniformën e një ushtrie çlirimtare, madje komandant (i cilit do nivel) vetvetiu të bën të kesh mbaruar funksionin kryesor të jetës që mund ta kryejë një njeri si individ.

Komandantët e UÇK-së do të duhej të ishin të parët që do të duhej ta mbronin fillimisht veprën e vet jetësore, bashkë me të do t'i mbronin edhe ushtarët, dinjitetin dhe veprën e tyre jetësore "ushtarë lirie".

Liria e Kosovës solli edhe shqetësim e frikë për bashkëpunëtorët e regjimit të Serbisë, fatkeqësisht duhet pranuar se ata nuk ishin të paktë. Këta individë që u ndien të frikësuar nga të bëmat e UÇK-së si me magji "kalasë së UÇK-së" iu futen nga brenda, shfrytëzuan dobësitë e figurave kryesore të UÇK-së (përjashtoj ndonjë rast të izoluar) atyre iu ofruan para të cilat shumica e komandantëve nuk i kishin, duke pasur parasysh se pozitat veç i kishin, mund të thuhet se kriteri i thënies "për ta njohur njeriun jepi para dhe pozitë" po vihej në sprovë.

Për të mos i lënë asgjë rastit, por edhe për t'u përafuar edhe më shumë me komandantët, të frikësuarit u treguan edhe më gjeneroz, ofruan partneritet për ta në biznese dhe lavire.

Se kush ishin komandantët tashmë opinioni e di, por kush ishin të frikësuarit, secili që në kohën e luftës kishte moshë madhore e di se kush ishin mercenarët e bashkëpunëtorët e regjimit në lokalitetin ose komunën e tyre.

Këta mercenarë e bashkëpunëtorë, duke qenë të lidhur me shërbimet sekrete, vepruan sipas direktivave të tyre e që në Kosovën e pasluftës kanë vepruar një numër relativisht i madh i këtyre shërbimeve, por që më i strukturuar ka qenë shërbimi sekret serb. Besoj se më së miri e përshkruan me një fjali tashmë i ndjeri Adem Demaçi, cili, pas përfundimit të luftës, pati thënë: "Në qershor të vitit 1999 nga Kosova u largua çizmja-uniforma e fundit serbe, por do të nevojiten 50 vjet për ta larguar shërbimin sekret serb!"

Realiteti i sotëm vetëm sa e betonon edhe më shumë këtë thënie largpamëse të Demaçit. Si rezultat i këtyre argumenteve sot kemi komandantë politikanë, komandantë biznesmenë, komandantë zhigolë, komandantë..., por pothuajse të gjithë kanë të përbashkëta në vazhdim:

1. Pothuajse që të gjithë kanë me qindra mijëra e deri në miliona euro të deponuara në llogari bankare, (por që nuk kanë madje as librezë pune).

2. Pothuajse që të gjithë kanë nga disa biznese, (por që, në fakt, nuk dinë as elementet bazë se çka është biznesi e ndërmarrësia).

3. Pothuajse që të gjithë me nga disa prona - hotele, shtëpi, banesa, lokale... (por që, në fakt, nuk e dinë çka është trashëgimia).

4. Pothuajse që të gjithë, përveç gruas, kanë edhe disa lavire (por që, në fakt, nuk dinë çka është bordeli dhe prostitucioni).

Mbështetur në këto fakte, njeriu mund të gjejë sa të dëshiron shembuj e krahasime, mund të gjejë pjesë për humor e satirë, mund të... por, çuditërisht, pothuajse nuk mund të gjejmë as edhe një rast të vetëm që një komandant i UÇK-së i niveleve të larta që i takon grupit të lartpërmendur (1 deri në 4) e që për bashkëpunëtorë të afërt ta ketë një ushtar të vijave të para të luftës. Nëse dikush nga ju nuk e di apo hamendëson, pse nuk kanë përzgjedhur për bashkëpunëtorë ushtarët e vijave të para të frontit, po ju dhe dy argumente dhe atë:

- Jo pse ushtarët e vijave të para të luftës janë të paditur, përkundrazi, por ushtari i UÇK-së, ai i vijës së parë të luftës, luftën për liri e ka pasur pa djallëzi e interesa, rrjedhimisht këto dukuri negative të komandantëve do t'i luftonte.

- Komandantët nuk do të mund të flisnin dhe të shpiknin lloj-lloj tregimesh e legjendash në prani të ushtarëve të vijave të para për të "bëmat" e tyre gjatë luftës para audiencës e cila nuk ishte e paktë

pas lufte në ahengje, ndeja e kafiteri të ndryshme.

Këto, por edhe shumë të bëra e të pabëra të pasluftës nga ana e komandantëve, i bëjnë ata përgjegjësit më të mëdhenj për degradimin e vlerave të UÇK-së paslufte, komandantët jo vetëm se nuk ishin të papërgatitur për t'u përballur me shërbimin sekret serb, por as që kishin idenë se si funksionojnë shërbimet inteligjente, rrjedhimisht shërbimi sekret serb e shfrytëzoj në mënyrën më të mirë të mundshme shtrirjen e strukturave që kishte në terren për të lobuar kundër vlerës më sublime të shqiptarëve të shekullit të kaluar, madje këtë e bëri, po e përsëris, duke u futur brenda "kalasë së UÇK-së".

Deputetë e qeveritarë

Për të ndërtuar një shtet duhen institucione. Ndër shtyllat kryesore institucionale të një shteti janë Kuvendi dhe Qeveria, institucione këto që përbëhen nga njerëz që në demokracinë të cilën e pretendon Kosova, i nënshtrohen procesit të votimit. Këta njerëz vijnë nga subjektet politike, pse jo edhe nga bota akademike dhe shoqëria civile por që, fatkeqësisht, këto dy segmente të rëndësishme të shoqërisë, partitë politike të Kosovës i gëllitnin me një gllënjë sa herë që ato tentonin të futeshin në Kuvend. Prej përfundimit të luftës në Kosovë u organizuan disa palë zgjedhje, kryesisht të lira e demokratike, edhe pse disa prej tyre me manipulime e mashtrime, por në të gjitha rastet të pranuar nga subjektet politike pjesëmarrëse.

Subjektet politike pranuan rezultatet për interesa të tyre ose më mirë të thuhet për interesa të individëve që udhëheqin këto subjekte, madje gjuha dhe fjalori i kundërshtarëve politikë ndryshonte në mënyrë radikale prej fazës para në fazën paszgjedhore.

Sistemi zgjedhor tek ne lë shumë për të dëshiruar, nëse për asgjë tjetër, së paku për faktin se nuk kemi përfaqësim proporcional as në përqindje të përkatësive etnike e as në proporcion me numrin e banorëve të një komune a regjioni. Deputetët e zgjedhur fillimisht konstituojnë përbërjen e radhës së Kuvendit, zgjedhin kryetarin e Kuvendit dhe zëvendëskryetarët, pastaj institucionet si Qeverinë, presidentin, e nga këto institucione ndërtoheshin institucione si gjykatat e prokuroria e kështu me radhë.

(Vijon)

Senatori McCain nderohet me ceremoni në Arizona dhe Uashington

Uashington, 27 gusht - Senatori John McCain, i cili vdiq të shtunën pas një beteje të gjatë me kancerin në tru, do të nderohet me ceremoni në Arizona dhe Uashington. Trupi i tij do të vendoset së pari në kapitolin e shtetit të Arizonës, ku nesër (e mërkurë) do të mbahet një ceremoni private, me rastin e 82-vjetorit të ditëlindjes.

Të enjten në një kishë baptiste të qytetit Feniks do të mbahet një shërbim përkujtimor privat me

pjesëmarrjen e publikut.

Në Uashington, ku flamujt në institucionet e ndryshme janë ngritur në gjysmështizë, trupi i senatorit McCain do të vendoset të premten në ndërtesën e Kapitolit, ku njerëzit do të bëjnë homazhe.

McCain do të jetë senatori i 13-të amerikan, trupi i të cilit nderohet në sallën ovale të Kapitolit, një nder që u rezervohet "qytetarëve më të shquar" të vendit, sipas zyr-

tarëve të Kapitolit.

Të shtunën në Katedralen Kombëtare të Uashingtonit do të mbahet një shërbim përkujtimor, ku do të flasin ish-presidentët Barak Obama dhe Xhorxh W. Bush.

Senatori McCain do të prehet në Varrezat e Akademisë Detare në Anapolis të shtetit Marilend, pranë mikut më të ngushtë që ai kishte gjatë viteve të Akademisë Detare, admiralit Chuck Larson.



50 vjet nga pushtimi sovjetik i Çekosllovakisë

Në gusht të vitit 1968 tanket sovjetike sulmuan Çekosllovakinë komuniste. Qeveria sovjetike i siguroi qytetarët e saj se trupat ishin atje për të ofruar "ndihmë miqësore"

PRAGË, 27 GUSHT - Pesëdhjetë vjet më parë Bashkimi Sovjetik i atëherëshëm tronditi botën duke pushtuar aleatën e vet komuniste, Çekosllovakinë. Por, në Moskë, pushtimi sovjetik nxiti një protestë që do të bëhej një moment i rëndësishëm për të drejtat e njeriut në Rusi dhe në lëvizjen pro-demokracisë. Në gusht të vitit 1968, tanket sovjetike sulmuan Çekosllovakinë komuniste. Qeveria sovjetike i siguroi qytetarët e saj se trupat ishin atje për të ofruar "ndihmë miqësore". Por pushtimi shkaktoi dëshpërim mes aktivistëve rusë pro-demokracisë, të cilët, me goditjen në Pragë, panë një nxitës për reprimet të mëtejshëm në vend.

Kishte shpresë se Çekia do të filonte disa reforma të cilat do të ndihmonin jo vetëm çekët, por edhe në Rusi, nëse do të zbatoheshin.

Pavel Litvinov, atëherë një fizikan 28-vjeçar, ishte një nga tetë rusë të cilët fshehurazi u drejtuan te Sheshi

i Kuq në Moskë për ta shprehur mbështetjen për shokët e tyre çekë dhe slovakë. Ndërsa ora e Kremlin shënoi 12, ata shpaleshin një pankartë ku shkruhej: "Për lirinë tuaj dhe tonën".

Demonstrata zgjati vetëm pak minuta para se të ata të rriheshin dhe të ndaloheshin nga policia. "Nuk kisha asnjë dyshim, dhe prisja shtatë vjet kamp pune si shumë nga miqtë e mi për të ashtuqajturën propagandë antisovjetike", thotë Litvinov.

Litvinov u dënua me pesë vjet punë të detyruar në një kamp minierash siberiane. Ai më vonë emigroi në Shtetet e Bashkuara. Demonstruesit e tjerë u përballën me një fat të ngjashëm ose u shtruan në reparte psikiatrike sovjetike. Por ai ishte një moment përcaktues për lëvizjen disidente dhe pro-demokracisë që do të vinte. "Njerëzit jo më kot shkuan në burg apo në mërgim. Ai nuk ishte thjesht një demonstrim i vetëm që të gjithë



e harruan shpejt. Ajo rezonoi shumë", thotë Ksenia Sakharnova, drejtoreshë e dokumentarit "5 minuta liri".

Megjithatë, sot, anketat tregojnë se pothuajse gjysma e të gjithë rusëve nuk janë në dijeni të pushtimit të vitit 1968 - dhe aq më pak për protestën në Sheshin e Kuq që pasoi. "Njerëzit 35 vjeç apo më të rinj nuk dinë asgjë për këto ngjarje, por ajo ka rëndësi ndërkombëtare. Që nga ai moment, Bashkimi Sovjetik filloi të zhdukej dhe njerëz-

it filluan të bëheshin më të lirë", thotë 19 vjeçja Alisa.

Bashkimi Sovjetik nuk ekziston më prej kohësh, por presioni i shtetit ndaj opozitës dhe kritikëve të Qeverisë në Rusi nuk është gjë e së kaluarës.

Në luftën aktuale të Kremlin në Ukrainë dhe kufizimin e lirive politike, anëtarët e familjeve të demonstruesve të Sheshit të Kuq shohin ngjashmëri me atë që ndodhi në vitin 1968. "Nëse atëherë historia ishte se si Çekosllovakia kishte liritë

dhe i humbi nën tanke, sot historia është se si rusët fituan lirinë dhe më pas e humbën, ose po e humbasin. Dhe përsëri ka tanke - jo në Sheshin e Kuq, ata janë tani në Ukrainë dhe në Krime", thotë Yaroslav Gorbanevsky, djali i protestueses Natalya Gorbanevskaya.

Në një ceremoni për ta shënuar protestën e vitit 1968 në Sheshin e Kuq, Litvinov bëri thirrje për lirinë e të burgosurve të sotëm politikë, ndërsa policia ndërhyri ndaj dy demonstruesve.

Macroni kërkon projekt të ri të mbrojtjes së Evropës



PARIS, 27 GUSHT - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, bëri thirrje për një projekt të ri të mbrojtjes së Evropës, duke thënë se siguria e kontinentit nuk duhet të mbështetet aq shumë në Shtetet e Bashkuara. "Duhet t'i përmbushim përgjegjësitë tona dhe ta garantojmë sigurinë tonë, e në këtë mënyrë edhe sovranitetin evropian", tha Macroni në një fjalim para

ambasadoreve francezë në Paris. Ai shtoi se bisedimet për bashkëpunimin në mbrojtje duhet të zgjerohen të gjitha shtetet evropiane dhe Rusia.

Që nga zgjedhja president në maj të vitit 2017, Macroni ka bërë thirrje për një Bashkim Evropian më të integruar, me një buxhet të përbashkët të mbrojtjes dhe doktrinë të sigurisë. Në nëntor vendet evropiane kanë nisur një

epokë të re në bashkëpunimin në mbrojtje, me një program të investimeve të përbashkëta ushtarake dhe zhvillim të projekteve që synojnë ta ndihmojnë BE-në të përballë me sfidat e sigurisë.

Njëzetetë prej 28 vendeve anëtare të BE-së e kanë nënshkruar programin, i njohur si Bashkëpunimi i Përhershëm i Strukturuar, ose PESCO.

Papa hesht për letrën rreth pretendimeve për abuzime seksuale

VATIKAN, 27 GUSHT - Papa Françesku ka refuzuar të përgjigjet ndaj pretendimeve të një ish-diplomati të Vatikanit, peshkopit Carlo Maria Vigano, i cili i ka kërkuar të dorëhiqet. Peshkopi Vigano e ka akuzuar Papën për mbulim të akuzave rreth abuz-

imeve seksuale nga një kardinal amerikan.

Papa është pyetur për akuzat nga gazetarët teksa ishte duke u kthyer në Romë, pas vizitës së tij në Irlandë. Ai ka thënë se nuk do të flasë as edhe një fjalë për letrën 11 faqe të peshkopit Vigano. "Lexoni

me kujdes dokumentin dhe gjykoni personalisht. Unë nuk do të flas asgjë për këtë. Mendoj se deklarata flet vetë", u shpreh ai. Letra është publikuar teksa Papa ishte duke mbajtur një fjalim për abuzimet seksuale nga priftërinjtë gjatë një vizite në Irlandë. Ky doku-

ment ka ngritur dyshime nëse Papa po përballë me sulme të koordinuara nga tradicionalistët në hierarkinë katolike. "Ju keni kapacitet të mjaftueshëm për të krijuar përfundime. Kur të kalojë koha dhe të keni përfundimet, ndoshta do të flas", tha Papa.



Dua Lipa thyen rekordet



Music News Facts
@musicnewsfact

.@DUALIPA is now the FIRST & only female artist in HISTORY to have 4 lead songs with over 500 MILLION streams on Spotify!



Ajo është një prej femrave më të komentuar dhe ndjekura në të gjithë botën. Bëhet fjalë për këngëtarën me origjinë shqiptare, Dua Lipa, e cila po shijon majat e suksesit në muzikë. Këngëtarja na ka bërë të gjithëve krenarë dhe së fund-

mi na ka gëzuar më shumë kur ka ndarë me ndjekësit lajmin e bukur se me sukseset e saj ka hyrë në histori. Dua është femra e parë dhe e vetme që kryeson në aplikacionin "Spotify" me katër këngët e saj, gjë e cila nuk ka ndodhur asnjëherë më parë.

Ariana Grande dhe Pete Davidson puthen në skenë



Ariana Grande dhe Pete Davidson janë aq të dashuruar sa e tregojnë këtë gjë vazhdimisht. Këngëtarja 25-vjeçare e "God Is a Woman" ka puthur të fejuarin e saj 24-vjeçar në skenë, në një ngjarje në Los Angeles, ku ajo

është duke promovuar albumin më të ri. Grande kishte të veshur një bluzë ngjyrë rozë me mbishkrime të albumit të saj "Sweetener" dhe një palë çizme të gjata, derisa Davidson kishte veshur një bluzë të zezë dhe pantallona të bardha.



Fansi i dehur shkakton kaos në koncertin e Beyoncé dhe Jay Z

Një fans i dehur ka shkakuar kaos në një koncert të Beyoncé Knowles dhe Jay-Z në Atlanta, pasi është ngjitur në skenë dhe ka vrapuar në drejtim të çiftit të famshëm, gjatë koncertit në kuadër të turneut të tyre 'On the

Run II'. Në rrjetet sociale janë publikuar disa video, ku shihen valltarët fillimisht të habitur, pastaj duke vrapuar pas ekipit organizues të koncertit ka publikuar një komunikatë ku thuhet se "një mashkull i dehur ishte ngjitur në skenë".

Snoop Dogg shkruan libër gatimi



Snoop Dogg do ta publikojë librin e parë të gatimit "From Crook to Cook" në tetor. Rapper do t'i ndajë recetat e tij më të preferuara, nga karavidhet deri tek ëmbëlsirat. Në libër janë rreth

50 receta që ndahen në gatime për raste të veçanta dhe ushqime të përditshme. Snoop Dogg është më i njohur për një karrierë të muzikës rap që shtrihet deri në vitin 1992.

E jashtëzakonshme

Fshati francez që është i shkyçur nga ujësjellësi

Në shikim të parë, qyteti i vogël i Etais-La-Sauvin, rreth 200 kilometra në jug të Parisit, është fshati tipik francez, pasi që ndotja e tokës i ka privuar banorët e saj me ujë të pijshëm për më shumë se dy vjet. 700 banorët e këtij fshati duhet të pajisen me shishe me ujë mineral për të pirë, gatuar dhe larë.



FOTO E DITES




Në Uashington flamujt në gjysmështizë me rastin e vdekjes së senatorit John McCain. /AP/

E rrallë

Arkeologët turq zbulojnë varrin 3000-vjeçar

Në provincën jugore Kahramanas, arkeologët turq kanë zbuluar një varr i cili daton qysh para 3000 vjetësh. Një ekip i ekspertëve të arkeologjisë gjatë gërmimeve zbuloi një vazo ku ishte vendosur hiri i një të ndjeri. Kjo ndodhi në Krahuyuk në regionin e Elbistanit, pjesë e gërmimeve të zhvilluara që nga viti 2015.



BARSOLETA E DITËS



Bisedojnë dy shokë:
 - Bir, e kam zgjuar babin nga gjumi në orën 3:00 të mëngjesit.
 - Pse, hajvan?
 - Se, sapo ia filloi një film, në ekran shkroi: "Prania e prindit është e obliguar".



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 16:00

“INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



Në ora 18:20

“FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

“ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

“LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI
Nuk u keni kushtuar rëndësi të

dashurve tuaj dhe njerëzve të afërt dhe kjo gjë do t'ju penalizojë sot. Do t'i shihni shumë larg vetes.



DEMI
Nëse keni diçka intere-

sante për të bërë sot, mund të dilni jashtë kornizave. Në të kundërt, mos e ndryshoni fare vazhdimësinë e ditës.



BINJAKËT
Sot jeni mjaft të ekzaltuar sepse do

të merrni pjesë në një aktivitet disi të veçantë dhe që ka shumë anë misterioze për ju.



GAFORRJA
Po merrni intensivisht për

t'i shlyer një borxh moral një mikut tuaj. Ai ju është gjendur në çaste të vështira pranë dhe sot ka nevojë për ju.



LUANI
Nëse do të bëni misteriozet sot

me një person të saponjohur, do ta lini të krijojë përshtypje të gabuar për ju dhe për projektet tuaja.



VIRGJËRISHA
Dikush ju ka vendosur pengesa

në rrugën tuaj sot dhe do t'ju bëjë të humbni diçka me vlerë për të cilën kishit investuar prej kohësh.



PESHORJA
Sot e keni të nevojshme të

gjeni një person mjaft serioz për t'u marrë me një çështje të caktuar. Nuk mund t'u besoni atyre që ju rrethojnë.



AKREPI
Mos u hyni në sfidë me të tjerët sot

sepse në kushtet në të cilat ndodheni nuk ju nevojitet. Jeni disa hapa para dhe duhet shumë punë për t'ju arritur.



SHIGJETARI
Do të mbusheni me energji

pozitive sot dhe çdo plan do të përfundojë për atë që keni rënë dakord me partnerin.



BRICJAPI
Sot dikush do të mundohet

të justifikojë para jush një sjellje aspak dinjitoze. Edhe pse nuk do të reagoni tashmë nuk ju lidh asgjë me këtë person.



UJORI
Nëse keni planifikuar diçka për sonte në

darkë, mos e shtyni me pretekstin e vetëm që do të takoni një të panjohur. Ndonjëherë njerëzit e rinj janë me interesantët.



PESHQIT
Mezi po duroni bashkëjetesën me

një person të caktuar sot. Jeni të lumtur që ky takim nuk do të zë shumë orë të ditës suaj.

Kelly Clarkson u frymëzua nga një libër për të hequr kilogramë



Kelly Clarkson ka pasur një betejë shumë publike me peshën e saj. 34-vjeçarja ka thënë se më në fund gjeti një mënyrë për ta menaxhuar peshën dhe kjo ishte e gjitha në një libër. Libri foku-

sohet në atë se si kuzhinierët mund të gatujnë pa pesticide dhe promovon një dietë organike. Kelly thotë se humbjen e peshës e arriti duke ngrënë më mirë dhe se nuk ka nevojë për stërvitje.

Ben Afflecku dhe Jennifer Garneri shkurorëzohen



Ben Affleck dhe Jennifer Garner i kanë përfunduar procedurat e gjata të divorcit, ani pse Affleck është duke u rehabilituar për varësi ndaj alkoolit. Çifti u nda në vitin 2015 pas dhjetë vjetëve martesë, por pas

tre vjetësh ndarje do të finalizohet divorci i tyre pasi aktori ta përfundojë trajtimin. Pretendohet se çifti ka arritur marrëveshje për prona, po ashtu janë pajtuar edhe për kujdestarinë e përbashkët të tre fëmijëve të tyre.



Rita Ora krenare, me të ëmën

Këngëtarja Rita ora e ka vërtetuar tash e disa herë se është një artiste vërtet sociale me të tjerët. Gjatë vizitë së saj këtë vit në Kosovë (shkurt 2018) Ora i ishte bashkuar iniciativës "Bëhu zëri im". Kjo iniciativë mbështet të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Të njëjtën iniciativë e

përkrah edhe nëna e saj, Vera Sahatçiu, e cila është psikiatre me profesion. "Shumë krenare me ty, Vera Ora, që përdor diturinë dhe edukatën tënde për t'u ndihmuar këtyre grave që kanë qenë viktimë e dhunës seksuale në luftë", ka shkruar Rita Ora në rrjetin social në "Instagram".

Eddie Murphy së shpejti baba për herë të dhjetë



Eddie Murphy është parë teksa po shëtiste me një kafe në dorë të shtunën në Los Angeles. Aktori 57-vjeçar mbajti një profil të ulët në një veshje sportive dhe syze dielli. Në fillim të kësaj jave u raportua se Eddie

do ta mirëpresë së shpejti fëmijën e vet të dhjetë. Eddie dhe Paige janë tashmë prindër të vajzës dyvjeçare Izzy, ndërsa aktori ka nëntë fëmijë të tjerë, përfshirë vajzën 11-vjeçare, Angel, me ish të dashurën e tij, Mel B.

UNIFIKIMI I REDAKSIVE NË FUNKSION TË PËRMBAJTJEVE MEDIALE TË KONVERGJUARA



SHPRESË MULLIQI

Ky shekull është shënuar nga një rritje e shpejtë e mediave të reja, të bazuara në internet, që mundësojnë informimin e konsumatorëve me përmbajtje mediale të formateve të ndryshme në një pajisje të vetme, falë konvergencës së mediave. Ky punim analizon efektet e konvergencës mbi mediat, duke pasur parasysh se ajo është më shumë se (thjesht) një ndryshim teknologjik. Si bazë për vlerësimin e ndikimit të konvergencës mbi mediat e shkruara, ato elektronike dhe on-line shërben tendenca e zbehjes së kufijve në mes të mediave të ndryshme, por edhe të punës profesionale të gazetarëve dhe rolit tyre brenda medimeve. Konvergjenca, përveç ndryshimeve në aspektin teknologjik, para së gjithash, përfaqëson një ndryshim profesional dhe kulturor ngaqë konsumatorët inkurajohen të kërkojnë informata të reja dhe t'i bëjnë lidhjet ndërmjet përmbajtjes së shpërndarë mediale në platforma të ndryshme.

Një vend të posaçëm në këtë studim zë pasqyrimi i disa prej formave të konvergencës të strukturuar në mënyrë analitike: si konvergimi i redaksive - gazetarëve dhe personelit tjetër, prodhimi i lajmeve të formateve të ndryshme - dhe ndërveprimi i konsumatorëve si rezultat i digitalizimit. Nga analiza e mediave elektronike, mediave të shkruara dhe atyre on-line ky punim ofron një vështrim mbi konvergencën e mediave të Kosovës të strukturuar ashtu që mbulon fushat më të ndikuara dhe ato që mbesin për t'u diskutuar.

Unifikimi i redaksive në funksion të përmbajtjeve mediale të konverguara

Ka disa vite që ekspertët flasin për konvergencë e rrjeteve komunikuese, të përmbajtjes së mediave si dhe të pajisjeve, për të formuar një produkt me avantazhet e të gjitha atyre që deri para pak kohe kanë qenë të ndara në formë dhe shërbim.

Në dekadën e fundit evoluimi dhe shtrirja e rrjetit të internetit në medie (për informim), digitalizimi i mediave audiovizuale dhe rënia e qarkullimit të mediave të shtypura janë bërë faktorë të cilët i ka catur studiuesit dhe profesionistët e fushës së medias të mendojnë se konvergjenca mund të jetë sfida e radhës me të cilën duhet të merren ata. Numri i përkufizimeve mbi këtë koncept është i madh, aq sa është edhe numri redaksive të cilat tashmë e kanë eksploruar këtë

fushë (Silcock and Keith, 2006). Në literaturë kemi hasur në përpjekjet e studiuesve dhe profesionistëve të ndryshëm që ta definojnë konvergencën si rrjedhojë të partneritetit të shtuar mes gazetave, mediave audiovizuale dhe medieve on-line, gjë që ka kontribuar edhe në strukturimin e procesit të raportimit dhe shpërndarjes së lajmeve (Ketterer, S., Weir T., Smethers, J. S., & Back, J., 2004), gjë të cilën tashmë po e shohim edhe në mediat tona.

Sipas Graham Murdok (2000), konvergencën e mediave e definojnë nivele të ndryshme të veprimit, sepse konvergjenca prekë, së paku, tri fusha: 1) Teknologjinë e mediave; 2) Format dhe përmbajtjen e mediave; dhe 3) Ekonomitë e mediave. Ndërkohë që shumica e diskutimeve janë fokusuar në ndryshimet teknologjike, respektivisht në të ashtuquajturin revolucion digital të mediave (Baldwin, Thomas F; Mc Voy, D. Stevens & Steinfield, Charles, 1999), sipas Henry Jenkins (2006) konvergjenca, përveç ndryshimeve, në aspektin teknologjik dhe atë rregullator, para së gjithash, përfaqëson një ndryshim kulturor ngaqë konsumatorët inkurajohen të kërkojnë informata të reja dhe t'i bëjnë lidhjet ndërmjet përmbajtjes së shpërndarë mediale.

Në këtë kontekst, duhet përmendur se në dhjetë vjetshin e fundit diskutimi mbi konvergencën e mediave ka zënë vend në diskursin e mediave të Evropës, pavarësisht prej faktit se ajo si nocion është paraqitur, para më shumë se tridhjetë vjetësh, atëherë kur Ithiel de Sola Pool në librin Technologies of Freedom (1983) del me konceptin për një platformë të vetme të integruar të mediave (Mueller, 1999). Sipas Pool (1983), kompanitë që njëherë dhe një kohë kanë publikuar gazeta, revista dhe libra kanë bërë shumë pak në fushat e tjera, apo përfshirja e tyre ka qenë krejtësisht e shpërfillshme (Mueller, 1999). Ndërsa e tëra kjo ka ndryshuar falë zhvillimeve të cilat filluan në vitet tetëdhjetë kur, sikundër edhe u tha, u shfaq për herë të parë nocioni konvergencë. Është kjo periudha kur shkriret e një mediumi në tjetrin filluan të marrin hov, kur u krijuan korporatat e para mediale të cilat kishin më shumë se një produkt mediatik (Marsden, Christopher T. & Verhulst, Stefaan G, 1999).

Siç ndodh me çdo të re, edhe diskutimet e para mbi konvergencën kanë ngjallur dilemat mbi ndryshimet e shumta të cilat do t'i pësojë skena mediale, përfshirë edhe ndikimet që do të kenë implikime materiale. Këto diskutime në të cilat janë përfshirë ekspertët të fushës së mediave, teknologjisë, ekonomisë, legjislativit etj., kanë rishqyrtuar ndikimin të cilin do ta ketë konvergjenca e mediave në ekonomitë si dhe politikën mediatike në Bashkimin

Evropian, pra në tregun e përbashkët, si nevojë për avancimin e kornizës ligjore në të gjitha shtetet e unionit, por edhe më gjerë, në botë, në veçanti në kompanitë e mëdha mediale (Murdok, 2000). Meqenëse teknologjia moderne digjitale ua mundësoi sektorëve të ndryshëm që të bashkohen (Kent, 2007), konvergjenca, si e tillë, kishte një zhvillim dhe një shtrirje globale. Në këtë mënyrë i nisi dhe po i vazhdon fuqishëm ndryshimet, gati-gati revolucionare në mënyrën e komunikimit mes njerëzve përmes pajisjeve (Mueller, 1999).

Gjithashtu, gjatë hulumtimit tonë kemi hasur në debat mes atyre që konvergencën e shohin thjesht si zhvillim një teknologjik i cili është mundësuar nga pajisjet digjitale, si dhe atyre që thonë se konvergjenca duhet të definohet si një ndryshim rrënjësor për bartjen e mesazhit (Dailey, L., Demo, L. & Spillman, M., 2003). Ndërkohë që problemet kyçe të cilat mbesin për t'u diskutuar janë: mungesa e një përkufizimi të vetëm mbi konvergencën të bazuar në sjelljen e mediave si dhe mungesa e një instrumenti për matjen e të arriturave të konvergencës (Dailey dhe të tjerët, 2003), gjë që paraqet një sfidë për studiuesit të cilët, në mungesë të këtyre instrumenteve, e kanë të vështirë të bëjnë studime krahasuese, ndërkohë që as vetë profesionistët nuk mund të marrin vendime të bazuara në rezultate se si mund ta bëjnë më mirë punën e tyre, në rrethanat e krijuara.

Për ta strukturuar punimin tonë, me këtë rast jemi bazuar tek studimet e Dailey dhe të tjerët (2003), të cilët ofrojnë Vazhdimësinë e konvergencës (Convergence Continuum) si një orientues për ta studiuar konvergencën në një numër fushash të kërkuar në ndërlidhura me mediat. Këtë përzgjedhje e kemi bërë ngaqë, si e tillë, është tregues i mirë se jo me patjetër duhet t'i përcaktojmë në sasi përpjekjet në fushën e konvergencës, apo se me patjetër duhet të bazohemi në ndonjë nga teoritë këto pretendime. Përkundrazi, sipas Dailey dhe të tjerëve, ajo jep mundësi për t'i zhvilluar mjetet konceptuale dhe empirike të nevojshme për të kryer studime të këtylla.

Gjithashtu, në konceptimin e punimit ka ndihmuar edhe studimi i Graham Meikle dhe Sherman Young Konvergjenca e mediave: mediat e rrjetëzuara digjitale në jetën e përditshme (2007), sipas të cilit, konvergjenca mund të kundrohët në dimensione të cilat ata i kanë ndarë në katër: teknologjike, industriale, sociale dhe tekstuale (Meikle dhe Young, 2007:67). Me këtë rast, në punimin tonë shumëdimensionalitetin e konvergencës e kemi kundruar nga disa pikëshikime, gjë që ka bërë të mundur edhe vetë strukturimin e të gjeturave tona. Këtë e

kemi arritur gjithnjë duke u bazuar në konceptin e një platforme të vetme të integruar të mediave që kontribuon në strukturimin e procesit të raportimit dhe shpërndarjes së lajmeve (Mueller, 1999; Ketterer, S., Weir T., Smethers, J. S., & Back, J., 2004).

Shih për këtë, shkriren, respektivisht zbehjen e ndasive mes mediave në aspektin e profesional, në këtë punim e kemi analizuar nga pikëpamja e redaksive të integruara, konvergjenca dhe ridefinimi i rolit të gazetarëve, që ndërlihet edhe me shpërndarjen e produktit (lajmit) në shumë platforma, si rezultat i konvergencës dhe digjitalizimit të mediave. Secili dimension i lartpërmendur i konvergencës mund të analizohet edhe veç e veç, por nga literatura e konsultuar del se në të shumtën e rasteve studiuesit janë marrë me disa dimensione të një projekti mbi konvergencën si dhe atë se: nëse ato dimensione janë shkak pasojë e njëra-tjetrës.

Kryekrejtë, në këtë punim nuk jemi ndaluar në aspektin teknologjik të konvergencës ngaqë kemi bërë përpjekje t'i shmangemi determinizmit teknologjik dhe kështu, duke mëtuar që t'i ikim thjeshtësimin të analizës duke e kundruar konvergencën mediale thjesht si një efekt (Dupagne dhe Garrison, 2006), kemi arritur edhe përfundimet tona të synuara.

Si profesionistë nga fusha e mediave nuk mund mos ta themi se konvergjenca nuk është thjesht diçka që ka të bëjë vetëm avancimin e teknologjisë. Ajo, para së gjithash, paraqet një ndryshim rrënjësor në marrëdhënien në mes të prodhuesit të përmbajtjes (mediave) dhe konsumuesve të përmbajtjes (lexuesve, dëgjuesve dhe shikuesve) e që, njëkohësisht, ka edhe implikime ekonomike, sociale dhe politike (Mueller, 1999) tek vetë mediat, por edhe shoqëria. Konvergjenca e mediave ia mundëson audiencës të bashkëveprojë me prodhuesin e informatës si dhe ta prodhojë vetë përmbajtjen për t'u përdorur nga mediat në masë (Dahlgren, Peter, 1992). Ndaj ky punim mbulon parametrat relevantë që ndihmojnë për ta analizuar secilin dimension duke ofruar rezultate preliminare të cilat bazohen në studimin e gjashtë mediave të Kosovës (Radio Televizioni i Kosovës - Radio dhe të Radio Televizionit 21 dhe uebfaqja, të grupit medial Koha - Koha ditore dhe Kohavizioni dhe uebfaqja, të grupit medial Dukagjini - Radio dhe Televizioni Dukagjini dhe uebfaqja, të Klan Kosovës TV dhe uebfaqja si dhe të Agjencisë së Lajmeve Kosovapress - dhe uebfaqja) të cilat na dhanë mundësi t'i analizojmë dimensionet e lartpërmendura, të cilat janë në faza të ndryshme të konvergencës.

Të dhënat me këtë rast janë mbledhur duke i përdorur informatat të cilat janë të prezantuara në uebfaqen e mediave në fjalë dhe

udhëheqësit e mediave aty ku kishte nevojë për sqarime shtesë. Rezultatet e prezantuara janë të parat të këtij lloji e që japin sadopak një pasqyrë mbi konvergencën mediale në Kosovë dhe mund të shërbejnë si bazë për studime në të ardhmen.

Redaksitë e integruara

Një nga parametrat themelor të cilin e kemi vendosur për ta analizuar këtë dimension të konvergencës është shkalla e integritit dhe lloji i redaksive të përfshira. Njëqind për qind e kompanive të analizuara kanë zhvilluar një lloj të konvergencës së redaksive. Integrim të redaksive multimediale kanë katër kompani mediale nga gjashtë të analizuar, e që do të thotë gjithsej 66.6 për qind të tyre. Ndërsa koordinim të redaksive të ndara kanë vetëm dy kompani mediale, e që do të thotë 33.3 për qind të tyre.

Dy nga kompanitë mediale që kishin një lloj të integritit janë në nivel qendror, ku njëra është kompani mediale publike, tjetra kompani mediale private. Ndërsa nga analiza e bërë del se mediumi publik ka redaksi të ndara për të gjitha produktet e veta, edhe pse që të gjitha kontribuonin ose janë pjesë e uebfaqes përmes vjergëzave të krijuara tashmë. Nga analiza e kompanisë private mediale, produkt të së cilës janë një gazetë dhe një televizion, del se ajo ka redaksi të ndara si dhe uebfaqe të ndara. Ajo që vërehet këtu është se konvergjenca na shfaqet në formë të klonimit (Dailey dhe të tjerët, 2003), ku uebfaqja e njërit produkt medial publikon përmbajtjen e produktit tjetër, dhe televizioni bën promovimin e produkteve të gazetës.

Kompanitë e tjera, katër nga gjashtë të analizuarat, kanë redaksi të integruara. Kompanitë janë private dhe janë të vendosura në nivel lokal dhe qendror, e që lë të kuptohet se pronësia dhe vendndodhja nuk janë faktorë determinues për konvergencën e përmbajtjes. Madje mund të thuhet se kjo më parë ka të bëjë me numrin e punëtorëve dhe përdorimin e tyre në disa njësi sesa më efikasitetin në punë për ta shtuar produktivitetin e kompanisë. Vlen për ta theksuar se në të gjitha këto medime është vërejtur edhe një tendencë e ndër-promovimit (Dailey dhe të tjerët, 2003). Ndërsa e përbashkët e të gjitha këtyre mediave, kur bëhet fjalë për redaksitë e integruara, është ajo se përmbajtja e të gjitha produkteve mediale (si: audio, video dhe teksti i shkruar) është e shpërndarë nëpër platforma të shumëfishta të mediave (Meikle dhe Young, 2007:67).

Bashkëpunimi i redaksive është një praktikë të cilën e kemi vërejtur në të gjitha mediumet si në nivel kombëtar, po ashtu edhe në nivel vendor. Në disa nga kompanitë mediale, stafi i radios dhe tele-

vizionit, ta themi, i këmbëjnë stori e tyre dhe materialin audio-vizual, por ka edhe raste ku disa prej gazetarëve e përgatisin materialin për radio dhe televizion në të njëjtën kohë. Ky bashkëpunim ndonjëherë ndërlihet me gazetaret dhe jo me redaksitë, sado që në disa raste bëhet fjalë për të njëjtën redaksi që i mbulon të gjitha platformat: si radion ashtu edhe televizionin.

Redaksitë e integruara e prodhojnë lajmin dhe punojnë në tre ndërrime për t'i plasuar ato. Redaktorët janë ata që vendosin se cili produkt shkon në cilën platformë; nëse do të plasohet on-line apo do të botohet. Dhe gati se gjithnjë kur kanë ndonjë histori që tërheq vëmendjen e lexuesit e praktikojnë botimin e shkrimit në gazetë, ndërkohë që në uebfaqe nxjerrin vetëm kryetitujt dhe disa paragrafë sa për ta ngjallur kureshtjen e lexuesve.

Ajo që është më e evidente te kjo mënyrë e të punuarit, respektivisht tek kjo shkrirje e pjeshme apo e tërësishme e redaksive dhe gazetarëve, ka ndikuar te këta të dytët, pra gazetaret, që të evoluojnë në profesion si dhe të mendojnë për produktin e tyre edhe si gazetarë të mediave të shkruara, njëkohësisht edhe si gazetarë të mediave elektronike, një ndasi kjo e cila është vërejtur tek Radio Televizioni i Kosovës.

Konvergenca dhe ridefinimi i rolit të gazetarëve

Konvergenca e mediave mund të analizohet edhe nga këndvështrimi i ridefinimit të roleve profesionale dhe shkathtësive të gazetarëve, redaktorëve dhe të stafit përcjellës. Me konvergencën janë krijuar një numër i gazetarëve që mund të prodhojnë lajme/informata për të gjitha platformat. Ata janë zhvilluar ashtu që produktin e tyre mund t'ia përshtatin cilido medium pa humbur në kualitet. Sipas studuesve, kjo mënyrë e operimit iu leverdisë kompanive mediale sepse ul numrin e punëtorëve (Saltzis & Dickinson, 2003).

Mirëpo ajo që kemi vërejtur gjatë analizës së punës së mediave, pjesë të këtij punimi, është se këta gazetarë jo vetëm prodhojnë lajme/informata për platforma të ndryshme. Ata, për më tepër, kanë shkathtësi për të përcjellë edhe tema të ndryshme, njëkohësisht ta bëjnë edhe pjesën e paketimit të lajmit/informatës (thyerjen teknike/montazhin), pra janë të aftë ta marrin përsipër edhe punën e post-produksionit (Gunnar, 2014). Në mediat e analizuara, sipas stafit menaxhues, janë tre tipa gazetarësh;

"Gazetarë (ekspertë) që e mbulojnë vetëm një fushë ndërkohë që materialin e tyre e përpunojnë dhe e plasojnë në platforma të ndryshme të tjera (kryesisht redaktorët apo edhe kolegët më të rinj). Këta janë kryesisht gazetarë të gjeneratave të cilat nuk ia dalin të operojnë me teknologjinë e re multimediale;

"Gazetarë (ekspertë) që e mbulojnë vetëm një fushë dhe që e bëjnë thyerjen/editimin e materialit dhe përgatitjen për platforma të ndryshme. Këta janë kryesisht gazetarë të gjeneratave të cilat ia

dalin të operojnë me teknologjinë e re multimediale;

"Gazetarë që mbulojnë disa fushë dhe që e bëjnë thyerjen/xhirimin/editimin e materialit, e që jo me patjetër janë të thellë në punën e tyre, por që kanë njohuri dhe shkathtësi të cilat i bëjnë të pazëvendësueshëm sepse i realizojnë punët edhe të disa punëtorëve (profesionistëve) të tjerë.

Gjatë analizës së punës së mediave kemi ardhur në përfundim se gazetaret kanë përgjegjësi shumë më të mëdha sesa kolegët e tyre në redaksitë e ndara. Por, ajo që kemi vënë re është edhe se, performanca e tyre është më e dobët dhe jo gjitha e thellë, sidomos kur kanë të bëjnë me temat që kërkojnë përvojë dhe ekspertizë.

Të tre tipat e këtyre gazetarëve i kemi identifikuar në të gjitha mediumet që kemi analizuar për këtë punim. Ndërkohë që, tipi i parë syresh mbizotëron në mediumin publik, ku edhe janë të ndara përgjegjësitë e redaksive dhe të stafit të post-produksionit. Mirëpo ajo që është e përbashkët e të gjithë këtyre gazetarëve, është se puna e tyre dritën jeshile për publikim e merr nga kryeredaktori i cili e verifikon çdo punim para se i njëjti të publikohet në cilëndo platformë. Ndërsa, po ashtu, e përbashkët e të gjitha kompanive mediale është se asnjëra prej tyre nuk ka organizuar trajnime të veçanta për gazetarë me shumë shkathtësi. Ata këto shkathtësi i kanë fituar gjatë punës apo i kanë fituar jashtë mediumit.

Shpërndarja e produktit (lajmit) në shumë platforma

Shpërndarja e përmbajtjes mediale në shumë platforma është pjesa që më së shumti përfillet dhe e cila i atribuohet konvergencës. Është pjesa që në të vërtetë konvergencën e definon si një ndryshim rrënjësor në bartjen e mesazhit (Dailey, L., Demo, L. & Spillman, M., 2003). Nga këndvështrimi i konsumatorëve, konvergenca nënkupton produkte të ndryshme mediale që shpesh janë të lidhura me njëra-tjetrën jo vetëm në të shkruar, por edhe në prodhim, shpërndarje dhe marketing dhe, falë konvergencës dhe digjitalizimit, produktet e njëjta qarkullohen në forma të ndryshme të mediave (Marsden and Verhulst, 1999). Në fakt, mund të thuhet se është digjitalizimi ai që ka mundësuar shpërndarjen në shumë platforma, me qëllim që informata të arrijë te konsumatori pikërisht duke e përdorur punën e vetëm një gazetari, për ta mbuluar kështu një çështje të cilën më pas i njëjti do ta paketojë në formate të ndryshme. Sipas përfaqësuesve të mediave kjo shpërndarje në shumë platforma, faktikisht krijon mundësi që ato të jenë sa më të pranishme në opinionin publik dhe kështu, në këtë mënyrë, ta bëjnë tërheqjen e një numri sa më të madh të konsumatorëve të cilët do të kenë qasje në produktet e një mediumi në çdo kohë dhe në çdo vend.

Andaj dhe shpërndarja në shumë platforma e informatave gazetareske, është lloji i konvergencës më dominues në mediat e analizuara nga ne. Ndërsa mund të konstatohet edhe se, që të gjitha këto medime kanë përmbajtje

multimediale që ofrohet përmes platformave të ndryshme mediatike me të cilat operohet sot në treg.

Nuk do mend se mbizotëruese janë uebfaqet të cilat përditësohen 24 orë, pastaj janë aplikacionet të cilat ofrohen për të gjitha pajisjet mobile, por edhe platformat e ndryshme të rrjetëve sociale shumë të përhapura gjithandej. Radio dhe TV programet janë të pranishme në platforma live (transmetim në kohë reale) dhe on-demand (transmetim me kërkesë të konsumatorit) dhe e gjithë kjo mundësohet falë internetit dhe teknologjisë së re, por edhe angazhimit të kompanive mediale të cilat po tregohen gjithnjë e më kreative në krijimin e ofertave të reja për konsumatorët e interesuar.

Përmbledhje

Analiza e ofruar përmes kundërimit të shumëdimensionalitetit të konvergencës përmes analizës së disa fushave, e që janë prezantuar në këtë punim, mundëson një qasje gjithëpërfshirëse mbi zhvillimet në mediat e Kosovës. Ky model analitik mund të përdoret edhe në vendet e tjera si dhe për t'i analizuar zhvillimet e mëvonshme. Natyrisht të gjeturat tona kanë të bëjnë vetëm me mediat e analizuara dhe nuk mund të themi se janë përfaqësuese për të gjitha mediat e Kosovës (duke e pasur parasysh se numri

më i madh i mediave elektronike është në nivel lokal, ndërsa mundësitë e tyre për të ecur në hap me zhvillimet e teknologjisë multimediale janë më të vogla për shkak të pengesave financiare).

Meqenëse kjo analizë është e para e këtij lloji, besojmë se duhet t'i bëjmë disa konkludime.

Disa kompani mediale i kanë përfshirë të gjitha dimensionet e konvergencës të cilat u analizuan në këtë punim. Sipas të gjeturave tona, del se që të gjitha janë ende në fillimet e tyre për sa i përket konvergencës që të mund të themi se ofrojnë ndonjë vlerë e cila duhet të replikohet nga kompanitë e tjera mediale.

Ndërsa kur bëhet fjalë për redaksitë e integruara, bashkëpunimi mes redaksive të pavarura duket si qasje më e shpeshtë, për çka, përgatitja e lajmeve/informatave nga një person duket se përfaqëson gazetarin me shumë shkathtësi. Gazetari me shumë shkathtësi duket se është i vetmi dimension i cili mund të replikohet edhe në mediat e tjera sepse nga analiza del se gazetaret janë të aftë të krijojnë produkte për të gjitha platformat dhe se dallimet mes gazetarit të shtypit dhe atij të radios dhe televizionit janë shumë më të vogla sesa është menduar.

Duke e pasur parasysh se të gjitha dimensionet e konvergencës ishin shumë më të pranishme në mediat private, këtu del se shtesë për të gjitha këto procese është kompo-

nenti financiar: me pak punëtorë të cilët janë shumë produktivë në nivel të kompanisë. Paçka se, një analizë më e thellë do të na jepte një pasqyrë më të qartë mbi atë se cilat janë pasojat për kualitetin e lajmit/informatës si dhe cili është opinionin i gazetarëve për sa i përket angazhimit të tyre në të gjitha fushat pa ndonjë ekspertizë të thellë. Me këtë rast, hulumtimi ynë, edhe pse empirik, shpërfaqë ndërlihdjen e koncepteve teorike me praktikën e vërteta: të gjitha mediat e analizuara i kanë të zhvilluar disa nga dimensionet e përzgjedhura të konvergencës. Faktorë për përqafimin e këtyre dimensioneve nuk ishin as pronësia dhe as faktori i shtrirjes. Ndërsa rregullimi i sektorit të mediave të konverguara kërkon edhe rregullimin e shërbimeve të tjera gjë që identifikon një paradigme të re të konkurrencës në shërbimet e komunikimit (Marsden, Christopher T. & Verhulst, Stefaan G, 1999) Në mënyrë që të shpjegohen dinamikat e këtij zhvillimi nevojiten hulumtime të mëtejme. Këto hulumtime do të mund t'i pasqyronin edhe ndikimet e konvergencës në nivelin mikro dhe makro ekonomik.

(Fusnotat i ka hequr redaksia e gazetës "Epoka e re". Shkrimin, me fusnota, e gjeni në numrin e dytë të revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia")

MKRS-ja dha çmimet për Kinematografi

PRISHTINË, 27 GUSHT - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, të hënë në një ceremoni solemne ka bërë ndarjen e Çmimit Vjetor për Kinematografi dhe Çmimit Kombëtar për Vepër Jetësore "Bekim Fehmiu". Çmimi Vjetor për Kinematografi për vitin 2017 iu dha regjisorës Blerta Zeqiri, ndërsa Çmimi Kombëtar për Vepër Jetësore "Bekim Fehmiu" në fushën e kinematografisë iu dha regjisorit Besim Sahatçiu (postmortem).

Ministri Gashi ka thënë se përkrhja e MKRS-së për artistët do të vazhdojë. "Besoj se kemi pasur një juri profesionale për t'u ndarë çmimet dhe kemi ardhur deri te ky moment në këtë ceremoni për t'i ndarë këto dy çmime", është shprehur Gashi. Ai ka falënderuar për punën dhe kontributin e të ndjerit, regjisorit Sahatçiu dhe regjisorës Blerta Zeqirit. "Ne jemi të përkushtuar që ta motivojmë punën e artistëve dhe në këtë kontekst do të vazhdojmë të japim shpërblime e çmime. Jam tejet i lumtur që vendimmarrja e jurisë ka qenë e duhur dhe profesionale", ka thënë ministri Gashi.

Po ashtu, ministri Gashi ka bërë me dije se kanë rritur buxhetin



për 100 për qind.

Sipas vendimit për ndarjen e çmimit vjetor për Kinematografi, regjisorës Blerta Zeqiri i ndahet shpërblimi në vlerë monetare prej 2 500 eurosh, ndërsa sipas vendimit për ndarjen e çmimit kombëtar për Vepër Jetësore për "Bekim Fehmiu", regjisorit Besim Sahatçiu postmortem i ndahet shpërblimi në vlerë monetare prej 5 000 eurosh.

Çmimet u shoqëruan edhe me nga një plakat dhe nga një certifikatë të nënshkruar nga ministri. Juri profesionale, e përbërë nga Isa Qosja, Fadil Hysaj, Fatos Berisha, Ardiana Pajaziti dhe Kimete Berisha ka dhënë arsyetimin në lidhje me ndarjen e këtyre çmimeve. Sipas jurisë,

regjisorja Blerta Zeqiri, me filmin "Martesa" ka treguar sukses me pjesëmarrje në mbi njëzet festivale ndërkombëtare, ku është shpërblyer me çmime dhe mirënjohje të shumta, në mesin e të cilëve Çmimin Special të Jurisë "FIPRESCI" (Juria e Federatës Ndërkombëtare të Kritikës), në Festivalin e Kategorisë A "Black Nights Film Festival", Talin/Estoni. Pas marrjes së çmimit, regjisorja Blerta Zeqiri ka theksuar se ky çmim është një vlerësim i punës.

Po sipas jurisë, veprimtaria kinematografike e regjisorit Besim Sahatçiu konsiderohet themeltare e regjisorës kinematografike të Kosovës, që e avancoi atë në kinematografi konkurruese në nivel rajonal. Nga veprimtaria e tij vlen të përmendet filmi "117" dhe seriali filmik televiziv dhe filmi "Era dhe Lisi" që shënuan fillimin dhe konsolidimin e kinematografisë së Kosovës në vitet '70.

Për regjisorin Sahatçiu çmimin e mori bashkëshortja e tij, Besa Sahatçiu.

Me këtë rast ajo ka falënderuar ministrin për çmimin e dhënë. Ndër të tjera, ka pohuar se Besimi dhe Bekimi kanë qenë miq dhe, sipas saj, kontributi i tij ka qenë frymëzim.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

KIDDERMINSTER - STOCKPORT

1

SALFORD - BARROW

1

KALMAR - OREBRO

1

Gerrardi transferon Grezdën te Rangersi

Eros Grezda shumë shpejt do të prezantohet lojtar i Rangersit. Reprerentuesi i Shqipërisë ka arritur marrëveshje me skuadrën skoceze, e cila do t'i paguajë Osijekut rreth tre milionë euro për kartonin e tij. "Po, është e vërtetë se është arritur marrëveshja në mes të skuadrës së Rangersit dhe futbollistit Grezda. Shumë shpejt pritet të bëhet edhe zyrtarizimi", ka thënë një burim i gazetës, i afërt me Grezdën

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 GUSHT - Futbollisti i reprezentacionit shqiptar, Eros Grezda, ka arritur marrëveshje me skuadrën Rangers. Lajmin e ka konfirmuar një burim i "Epokës së re", i afërt me futbollistin nga Gjakova. "Po, është e vërtetë se është arritur marrëveshja në mes të skuadrës së Rangersit dhe futbollistit Grezda. Shumë shpejt pritet të bëhet edhe zyrtarizimi", ka thënë burimi në fjalë.

Skuadra skoceze po e dëshiron lojtarin e talentuar si zëvendësues të Jamie Murphy, i cili ka pësuar një lëndim të rëndë dhe për një kohë të gjatë pritet të jetë jashtë fushës së gjelbër. Gazeta ka mësuar se protagonist kryesor për transferimin e yllit shqiptar ka qenë trajneri i Rangersit, Stiven Gerrard, i cili sheh potencial të madh tek anësori Grezda. Ky i fundit verën e kaluar ishte transferuar tek Osijeku dhe për këtë klub është paraqitur në 26 ndeshje dhe ka shënuar pesë gola, kurse edhe në kombëtaren e Shqipërisë prej se është emëruar trajner Christian Panucci, Grezda është një nga protagonistët kryesor në fazën ofensive.

Eros Grezda kohë më parë kishte vlerësuar vitin 2017 si shumë të suksesshëm, duke bërë me dije se ëndrra e tij është që një ditë të luajë në një skuadër të Bundesligës ose Serisë A. "Deri më tash viti 2017 ka qenë më i suksesshmi për mua, por nuk do të ndalem me kaq. Normalisht se kam synime edhe më të mëdha, që të nënshkruaj me njëren prej ekipeve të mëdha në pesë ligat më të forta në Evropë, ku do të kisha dëshiruar të transferohem në Bundesliga ose Serinë A", kishte deklaruar ai. Në fakt, 23-vjeçari tash duhet të punojë me legjendën e Liverpoolit, Stiven Gerrard, e në të ardhmen ta realizoj ëndrrën për të luajtur në Gjermani ose Itali. Në karrierën e pasur futbollistike Grezda ka luajtur edhe për Lokomotivën, Aluminijin dhe Zavrqin, kurse në karrierën si junior luajti për Dinamo Zagrebin, Rabotniçkin dhe Prishtinën.



Lista e Kosovës për ndeshjet e shtatorit

PRISHTINË, 27 GUSHT - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll pritet t'i zhvillojë dy ndeshje në muajin shtator në kuadër të Ligës së Kombeve. Kosova që drejtohet nga Bernard Challandes do të përballet më 7 shtator ndaj Azerbajxhanit në udhëtim, kurse ndeshjen e dytë do ta zhvillojë më 10 shtator në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë ndaj Ishujve Faroe.

Lista e futbollistëve: Samir Ujkani, Arijanet Muriqi, Visar Bekaj, Amir Rrahmani, Kastriot Dermaku, Ardin Dallku, Fidan Aliti, Leart Paqarada, Benjamin Kololli, Brahim Vojvoda, Idriz Voca, Hekuran Kryeziu, Besar Halimi, Herolind Shala, Bersant Celina, Milot Rashica, Edon Zhegrova, Arbër Zeneli, Bernard Berisha, Elbasan Rashani, Vedat Muriqi, Atdhe Nuhiu, Donis Avdijaj.



SHKURT

Idrizi: Ofrova 250 mijë euro për Hasanin

Presidenti i Flamurtarit, Sinan Idrizi, në "Zona Gol" ka thënë se ka ofruar 250 mijë euro për sulmuesin e Shkëndijës së Tetovës, Ferhan Hasanin. "Lojtari që kam kërkuar me insistim ka qenë Ferhan Hasani, ish-sulmuesi i Shkëndijës së Tetovës. Ai më tha që duhet të prisnim që të kthente përgjigje. I kam thënë shihe dhe ofertën tonë dhe vendos. I ofrova 250 mijë euro, por atje ku ka shkuar (AL-Raed) merr shumë më tepër", ka thënë Idrizi.

Vibonese prezanton Edgar Çanin

Sulmuesi Edgar Çani është prezantuar sot te skuadra e Viboneses në Serinë C. 29-vjeçari rikthehet në futbollin italian pas një viti të kaluar në Shqipëri me Partizanin. Sulmuesi me skuadrën shqiptare luajti 11 ndeshje dhe shënoi një gol, kurse ai e prishi kontratën para kohës për t'iu bashkuar skuadrës së Viboneses. Çani në të kaluarën ka luajtur për Pescaran, Palermon, Ascolin, Padovën, Piacenzan, Modenën, Polonia (W), Catania, Carpi, Bari, Leeds dhe Pisen.

Henry refuzon Bordeauxin

Ish-sulmuesi i Arsenalit dhe Barcelonës, Thierry Henry, duket se do ta refuzojë ofertën e bërë nga Bordeaux për trajner. Sipas "Sky Sports", Henry është i shqetësuar me fondet që mund të ketë dhe mungesën e qartësisë sa i përket pronësisë të klubit të Ligës 1. Deri tash gjithçka ka qenë spekulim dhe nuk ka pasur konfirmim as nga Henry dhe as nga Bordeaux rreth rolit që mund të marrë si trajner, që do të ishte hera e parë për të.

Ish-trajneri i Stoke Cityt: Ishim me fat që e kishim Shaqirin

Ish-trajneri i Stoke City, Paul Lambert, ka lëshuar disa lëvdata në drejtim të Xherdan Shaqirit, pasi ky i fundit ishte kritikuar për mosangazhim dhe mungesë të profesionalizimit nga Gary Neville sa ishte pjesë e skuadrës që tani garon një ligë më poshtë në futbollin anglez. Shaqiri ishte bartësi kryesor i lojës sa ishte pjesë e skuadrës së Stoke City. Ai ishte lojtari më i mirë në skuadër dhe e gjithë skuadra pothuajse varej prej tij. Lambert i cili dështoi ta mbante skuadrën në Premierligë, i ka dalë në mbrojtje yllit kosovar, pas disa kritikave që iu drejtuan lojtarit. "Në 15 ndeshje asnjëherë nuk kam pasur problem me të. Është mrekulli të punosh me të. Nuk kishim probleme as kur zëvendësohej apo gjëra të tilla. Nuk mund t'ia mohojmë ato që 'Shaq' ka bërë për ne. Ishte lojtar i jashtëzakonshëm", ka thënë Lamberti.

Marcelo: Po na mungon Ronaldo

MADRID, 27 GUSHT - Cristiano Ronaldo është transferuar në Juventus nga Real Madridi. Ylli portugez qëndroi për nëntë vjet te "Los Blancos", duke fituar të gjithë titujt e

mundshëm, përfshirë katër herë Ligën e Kampionëve. Largimi i tij po u mungon lojtarëve të Real Madridit. Njëri nga ta që ka folur është zëvendëskapiteni, braziliani

Marcelo, i cili ka thënë se Ronaldo po u mungon. "Ronaldo nuk harrohet. Ai ka qenë shumë i rëndësishëm për Realin pasi ka shënuar shumë gola dhe ka ndihmuar

klubin. Na mungon Cristiano, pasi fjala është për lojtarin më të mirë në botë, por edhe Bale dhe Benzema janë shumë të mirë", ka thënë Marcelo.



PSG-ja motivon Buffonin



PARIS, 27 GUSHT - "Duket e pabesueshme, por ndihem shumë më mirë se para 5-6 vjetësh kur luaja për Juventusin", ka qenë deklarata e portierit legjendar Gianluigi Buffon që, pas një jete me bardhezinjtë këtë verë, u transferua në Francë, ku luan për skuadrën kampione të PSG-së. Në një intervistë për "France Football", portieri italian shprehet: "Kam ndryshuar metodat e punës dhe mendoj se gjithçka vjen se këtu jam më i motivuar. Pasi kam jetuar për 40

vjet në Itali, nuk është e lehtë ta ndryshoj ritmin e jetës. Isha pak i shqetësuar pasi nuk e dija se si do të më prisnin lojtarët e tjerë. Te Juvja kisha krijuar një zonë qetësie dhe rehatie dhe për frikë apo për ndonjë arsye tjetër refuzoja të nisja një jetë të re, pasi më dukej e frikshme". Më tej, numri 1 i portës italiane thotë: "Më pëlqen t'i vë në lojë aftësitë e mia por, për sa i përket faktit se dua të jem kompetitiv, nuk trembem. Më pëlqen të përballim me vështirësitë dhe të provoj për t'i

kaluar ato. Konkurrenca te PSG nuk më tremb, ndihem mirë me Areola dhe Trapp. PSG do të luajë rreth 60 ndeshje në sezon, ndaj është logjike që të jenë tre portierë titullarë dhe jo vetëm një". Më tej, duke folur për jetën e tij të re në Paris, portieri 40-vjeçar shton: "Erdha në Paris ashtu sikurse vjen çdo lojtar tjetër. Kështu dua të më shohin e vlerësojnë të gjithë. Këtu gjeta një grup djemsh fantastikë dhe më pëlqen të ndaj me ta gjithçka në sport".

Hamiltoni përgëzon Vettelin për fitore

BRUKSE, 27 GUSHT - "E përgëzoj Vettelin për fitoren. Unë bëra gjithçka që ishte e mundur për ta fituar garën, por besoj se në pistën e Spa ky ishte maksimumi unë. Kur më parakaloi në xhiron e parë, nuk e pashë fare manovrën e tij. Ferrari përdori një truk special për të ecur fort në atë pjesë të pistës", ka thënë Lewis Hamiltoni që, edhe pse e nisi garën e Belgjikës nga vendi i parë, në fund u klasifikua i dyti. Pavarësisht prej kësaj, piloti britanik i Mercedesit qëndron në krye të renditjes së botërorit të Formulës 1. "Nuk ishim aq të shpejtë sa Ferrari, ndaj brenda një jave, deri në garën e Monzas, duhet të përpiqemi ta rikuperojmë terrenin e humbur në Spa. Ne u përpoqëm ta parakalonim pas largimit të makinës së sigurisë, por nuk ia dolëm mbanë. Ata kishin diçka të veçantë në këtë garë, të cilën ne



nuk e zotëronim dot. Megjithatë, beteja do të vijojë deri në fund", ka shtuar Hamiltoni, që ka 17 pikë

avantazh karshi Vettelit në renditjen e përgjithshme të kampionatit për pilotë.

SHKURT

Soni shpreson t'i shmangët ushtrisë

Sulmuesi i Tottenham Hotspurit, Son Heungmin, vazhdon të shpresojë për një medalje në Lojërat Aziatike që po mbahen këtë muaj. 26-vjeçari po merr pjesë në këtë kompeticion për t'i shpëtuar dënimit të tij për ta kryer ushtrinë. Skuadra e Koresë nuk arriti në Kampionatin Botëror dhe ky është një dënim i parashikuar në një ligj të vendosur para fillimit të botërorit që u zhvillua në Rusi. Skuadra e 23-vjeçarëve të Koresë ka arritur një fitore dramatike, e cila e lumturoi jashtë mase lojtarin e Tottenhamit. Ata kanë arritur të fitojnë me rezultatin 4-3 përballë skuadrës së Uzbekistanit dhe goli i fitores u shënuar në minutën e 117. Kështu Son ka ende shanse ta fitojë medaljen e arit me skuadrën e tij dhe t'i shpëtojë këtij dënimi.

Strootmani transferohet te Marseille

Kevin Strootman është futbollist i ri i skuadrës së Marseillet. Mesfushori i Kombëtares së Holandës i ka kushtuar skuadrës franceze 25 milionë euro, kurse ka nënshkruar një kontratë pesëvjeçare. Strootman do të punojë sërisht me trajnerin Rudi Garcia, i cili në të kaluarën e kishte udhëhequr skuadrën e Romës. 28-vjeçari ka luajtur edhe për PSV-në, Sparta Rotterdamit dhe Utrechtin.

Rudy nga Bayerni në Schalke


Mesfushori i Kombëtares së Gjermanisë, Sebastian Rudy, karrierën futbollistike pritet ta vazhdojë në skuadrën e Schalke 04. Mediet gjermane raportojnë për një marrëveshje të arritur në vlerën prej 16 milionë eurosh. Mesfushori 28-vjeçar do të luajë për Schalken në katër vjetet e ardhshëm, derisa në Bayern Munchen u transferua një vit më parë nga Hoffenheimi.

Rooney: Mourinho synon titullin


Ish-sulmuesi i Manchester Unitedit, Wayne Rooney, beson se trajneri Jose Mourinho ka një plan për ta përmirësuar skuadrën e tij dhe t'i drejtojë atë për ta fituar titullin e Premierligës këtë sezon. "Ata kanë kualitet në skuadër, vetëm duhet të vazhdojmë të punojnë. Mourinho e di se çfarë po bën dhe ai e di si të fitojë tituj. Jam i sigurt se me kualitetin e lojtarëve që ka në skuadër, ai planifikon ta fitojë titullin e Premierligës", ka thënë Rooney.

"US Open", turneu i milionave për një përplasje "titanësh"


Edicioni i 138 i turneut të tenisit "US Open", që nisi këtë të hënë, është "Grand Slam"-i i fundit sezonal dhe ai që ka zgjuar kërshërinë e tifozëve. Kampioni në fuqi, Rafael Nadal, përfundoi në anën më të lehtë të tabelës, ndërsa dy gjigantët e tjerë të fushës, Federer dhe Djoković, me shumë gjasë do të përplasen në çerekfinale, nëse nuk ka surpriza të bujshme. Shpërblimet financiare sivjet në "tokën e premtuar" do të jenë një rekord më vete. Amerikanët kanë premtuar se do të shpërndajnë plot 53 milionë euro për pjesëmarrësit deri në sfidën e fundit, një pasuri e tërë, edhe pse gjigantët e tenisit kanë shumë pak nevojë për stimuj në këtë aspekt. Për kompanitë e basteve, favoriti kryesor është Novak Djoković. Serbi është ai që, sipas "Bookmakers"-ave, ka më shumë gjasa të triumfojë në finalen e madhe në "Flushing Meadows". Pasi fitoi turneun e Cincinnati, tenisti ballkanas nuk do të ketë gjithsesi një rrugë të lehtë. Surprizat ndoshta janë rezervuar që në fillim, por duket se edhe rruga e Rafael Nadalit drejt finales së madhe është tashmë e asfaltuar.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QENDRA Kryesore e Mjekësisë Familjare
GLAVNI CENTAR PORODIČNI MEDICINU
MAIN CENTER OF FAMILY MEDICINE
Nr. 303/018
Data: 20.08.2018.
SKENDERAJ



Kuvendi i Komunës Skenderaj
Skupština Opštine Skenderaj
Municipal Assambly Skenderaj

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale
Direkcija za Zdravstvo i Socijalno Blagostanje
Department of Health and Social Welfare

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – Glavni Centar Porodične Medicine – Main Family Medicine Center
Nr. 303 / 018
Datë: 20 / 08 / 2018.
Skenderaj

Në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Skenderajt 02 Nr.111/01-0047305/18 të dt. 17/08 / 2018, për lejimin e shpalljes së Konkursit për vendet e lira të punës për 6 (gjashtë) Infermier/e të përgjithshme për nevojat e QKMF-së, - Skenderaj, e në përputhje me nenin 7, 8, 10 paragrafi 1, nenparagrafi 2.1, nenit 15 paragrafi 1.2 dhe 3 të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr. 03/L-212, nenit 14 paragrafi 2 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udheheqesi i Administratës dhe personelit të QKMF-së, në Skenderaj, publikon këtë:

**KONKURS
PËR PRANIM NË MARRËDHËNIE PUNE**

I.- Titulli i vendit të Punës : Gjashtë (6) Infermier/e të Përgjithshme , në teren si vijon:

- Një (1) Infermie-r/e të Përgjithshme në QMF – Likofc ,
- Një (1) Infermie-r/e të Përgjithshme në QMF – Runik ,
- Një (1) Infermie-r/e të Përgjithshme në QMF- Prekazz i Epërm
- Një (1) Infermie-r/ e të Përgjithshme në QMF – Turiqec ,
- Një (1) Infermie-r/e të Përgjithshme në AMF – Açarevë ,
- Një (1) Infermie-r/e të Përgjithshme në AMF – Qubrel.

Kategoria dhe grada e vendit të punës

- Koeficienti : 4.80, H- 68 .
- Orari : 40 orë në javë ,
- Kohëzgjatja e Kontratës : Sipas Ligjit të Punës nr. 03/ L-212.

Detyrat dhe përgjegjësitë :

Pranon triazhon dhe informon pacientin , hapë kartelën shëndetësore dhe merr anamnezën orientuese , aplikon terapinë parenteriale ,i.m.iv . sub kutan ,aplikon infuzionet, bënë inhalimin ,përpunimin e plagës ,përcjellë kalendarin e imunizimit , aplikon dhënjën e oksigjenit , bënë audiogramet e nevojshme etj. Kryen edhe punë të tjera sipas sistematizimit të vendit të punës .Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit dhe Stafit Udheheqes të këtij Institucioni Shëndetësor .

Kushtet e Konkursit :

Kandidati/ja , të cilët konkurojnë për këtë vend të punës , përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj , duhet të këtë përfunduar :

- Bachelor i Infermierisë – drejtimi i përgjithshëm.
- Shkollen e mesme të mjekësisë – drejtimi Infermieri e përgjithshme,
- Kandidati/ja , duhet të këtë Licencën e Punës .

Dokumentet e kerkuara :

- Kopjet e Diplomës së shkollimit të kryer ,
- Kopjen e Licencës së Punës ,
- Çertifikatën e lindjes ,
- Kopjen e Leternjoftimit ,
- Çertifikatën që nuk është i denuar dhe nën hetime ,
- Çertifikatën e mjekut ,
- Çdo dokument tjetër apo çertifikatë trajnimi - që kandidati/ja , e vlerëson të nevojshme që i përshatet kushteve dhe kriterëve të përcaktuara më lartë .
- Deshmi mbi njohjen baziqe të punës me kompjuter ; e dëshirueshme ,

Çdo aplikues duhet të plotësoi dhe dorëzoi dokumentacionin me sa vijon:

- Fletë aplikacionin e plotësuar (kandidati e cekë vendin për të cilin aplikon)
- Dokumentacionin mbi përgaditjen dhe kualifikimin profesional / fotokopje / e vertetur.

Të gjithë kandidatet të cilët hyjnë në listën e ngushtë , do të ftohen në intervist, dhe për datën e mbajtjes së intervistës do të njoftohen me kohë dhe do të intervistohen nga Komisioni Intervistues .


Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në Administratën e QKMF – Skenderaj (nga ora 8-15) .


Dokumentacioni i cili i bashkangjitet Aplikacionit duhet të jetë fotokopje dhe i njejt nuk kërkohet .

Dokumentacioni i cili nuk iu përgjigjet kërkesave dhe specifikeve të Konkursit si dhe dokumentacioni i pakompletuar dhe ai që arrinë me vonesë , nuk do të shqyrtohen .


Afati për aplikim është /15 / pesëmbdhjetë ditë , nga dita e shpalljes publike në Gazetë ditore dhe mjete tjera të Informimit .

QKMF-Skenderaj
Udheheqesi i Administratës e personelit
Behram Mehaj , Jurist i Dip.






Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Opština Skenderaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QENDRA Kryesore e Mjekësisë Familjare
GLAVNI CENTAR PORODIČNI MEDICINU
MAIN CENTER OF FAMILY MEDICINE
Nr. 303/018
Data: 20.08.2018.
SKENDERAJ



Komuna Skenderaj
Republic of Kosovo
Municipality Skenderaj

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale
Direkcija za Zdravstvo i Socijalno Blagostanje
Department of Health and Social Welfare

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare/Glavni Centar za Porodičnu Medicinu/ Main Family Medicine Center
Br. 303/018
Skenderaj/Srbica, 20.08.2018 g.

Na osnovu odluke Predsenedika Opštine Skenderaj br. 02-111/01-0047305/18, od dana 17.08.2018 god. od dana 17.08.2018 g., za odobrenje objavljivanja konkursa za slobodna radna mesta za šest (6) opštih Medicinske Sestre (infermiera), u okviru GCPM-a Skenderaj/Srbica i u skladu sa članom 7.8,10, stav 1, podstav 2.1, član 15 stav 1.2 i 3 Zakona o Radu Republike Kosova br. 03/L-212, člana 14 stav 2 Zakona o Zdravstvu u Republici Kosova br. 3/L-125, člana 4, Administrativnog Upustva MRSB br. 07/2017, za Regulisanje Procedura Konkursa u Javnom Sektoru, Rukovodilac Administracije i Personala u GCPM-u u Skenderaj/Srbici objavljuje sledeći:

**KONKURS
ZA PRIJEM U RADNOM ODNOSU**

I. **Naziv radnog mesta:** Medicinske Sestre, (Infermieri) šest (6) položaja:

- Jedan (1) Medicinska sestra (infermier) u CPM-u – Likovac;
- Jedan (1) Medicinska sestra (infermier) u CPM-u – Rudnik;
- Jedan (1) Medicinska sestra (infermier) u CPM-u – Gornje Prekaze;
- Jedan (1) Medicinska sestra (infermier) u CPM-u – Turičevac;
- Jedan (1) Medicinska sestra (infermier) u CPM-u – Ačarevo;
- Jedan (1) Medicinska sestra (infermier) u CPM-u – Čubrelj;

- Kategorija stepen radnog mesta:
- Koeficientat 4,80, H-68;
- Radno vreme 40 časova nedeljno;
- Trajanje Ugovora u skladu sa Zakonom o Radu, 03/L-212

Zadaci i odgovornosti:

Prima, tiražuje i informira pacienta, otvora zdravstvenu karticu i uzima orientiranu anamnezu i implicira aprenterialnu terapiju i.m.iv. sub kutan, postavlja infuzije, izvrši inhalim, obradu rane, prati kalendar imunizacije, aplicira davanje oksigena, izvršava potrebne ardiogram i td. Izvršava i druge poslove po sistematizaciji radnog mesta. Za svoj rad odgovara Glavnoj Medicinskoj Sestri i Drugom Rukovodstvu ove Zdrastvene Institucije.

Uslovi konkursa:

Kandidati koji konkuruju na ovo mesto osim opštih predvidenih uslova prema zakonu, treba imati završenu:

- Bachelor Medicine – pravac opšte Infermierstvo;
- Srednja medicinska škola – opšti pravac;
- Kandidat mora imati Licencu za Rad.

Potrebna dokumentacija:

- Kopiju Diplome Završene Škole;
- Kopiju Licence za Rad ;
- Rodjeni izvod;
- Kopiju lične karte izdate od MUP-a Republike Kosova;
- Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom od nadležnog Suda
- Lekarsko Uverenje;
- Svaki drugi dokumentat od raznih trajninga, koju kandidat procenjuje važnom za ovo radno mesto;
- Dokaz za dobro poznavanje rad na računaru-poželjna;

Svaki aplikant mora popuniti i predati sledeću dokumentaciju:

- Popunjena aplikacija (kandidat mora pomenuti radno mesto na kojoj konkuruje);
- Dokumentaciju o pripremi i stručnoj kvalifikaciji (overeno fotokopije).

Svih kandidati koji uđu u užu listu, će se pozvati na intervju, i za datum održavanja intervjuja biće na vreme obavesteni od strane određene Komisije za Intervju.


Aplikaciju se mogu dobiti prazne i popunjavaju se i predaju se u Administraciju GCPM-a Skenderaj/Srbica (od 8-15) časova.

Dokumentacija koja se priloži aplikaciji mora biti fotokopje i ista se ne vraća kandidatu.


Dokumentacija koja se ne odgovara uslovima i kriterie konkursa , nekompletirana dokumentacija i ona koja dolazi posle roka konkursa neće se razmatrati.


Rok za konkurisanje će biti petnaest (15) dana od dana objavljivanja konkursa u dnevnom novinu i drugim sredstvima informiranja.

Konkurs se objavlja u oba jezika.




G C P M Skenderaj/Srbica;
Rukovodilac Personala i Administracije
Behram Mehaj dipl.prav.






Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
GLAVNI CENTAR PORODICNE MEDICINE
MAIN CENTER OF FAMILY MEDICINE
No: 304/018
Data: 20.08.2018.
SKENDERAJ



Kuvendi i Komunës Skenderaj
Skupština Opštine Skenderaj
Municipal Assambly Skenderaj

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale
Direkcija za Zdravstvo i Socijalno Blagostanje
Department of Health and Social Welfare

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – Glavni Centar Porodicne Medicine – Main Family Medicine Center
Nr. 304 / 018.
Skënderaj, 20.08.2018.
Skenderaj


Në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Skenderajt, 02 Nr. 111/01-0047305/018 të dt. 20.08.2018, për lejimin e shpalljes së Konkursit për vendet e lira të punës për dy mjek / e të përgjithshëm në QKMF-së, në Skenderaj, e në përpundje me nenin 7, 8, 10 paragrafi 1, nenparagrafi 2.1, nenit 15 paragrafi 1,2 dhe 3 të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr. 03/ L- 212, nenit 14 paragrafi 2 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04 /I. - 125, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëheqesi i Administratës e personelit në QKMF –së, në Skenderaj, publikon këtë:

KONKURS
PËR PRANIM NË MARRËDHËNIE PUNE


I- Titulli i vendit të punës: Doktor i Mjekësisë, Dy (2) pozita:
Kategoria dhe grada e vendit të punës:
- Koeficienti 7.20, H-27.
- Orari: 40 orë në javë.
- Kohëzgjatja e Kontratës; sipas Ligjit të Punës nr. 03/ L – 212.

Detyrat dhe përgjegjësitë:
Punët dhe detyrat e punës do të kryhen në bazë të përshkrimit të detyrave të punës së Mjekut, të parapara sipas rregullorës mbi Organizimin e brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës të QKMF –së, kryen edhe punë tjera nga lëmia e mjekësisë familjare. Për punën e vet i përgjigjet Shefit dhe Drejtorit të QKMF –së, para të cilit është përgjegjës.


Kushtet e Konkursit:
Kandidati/ja, të cilët konkurojnë për këtë vend të punës, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të këtë të perfunduar:
- Fakultetin e Mjekësisë – Drejtimi i mjekësisë së përgjithshme.
- Kandidati/ja, duhet të këtë licencën e punës.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
GLAVNI CENTAR PORODICNE MEDICINE
MAIN CENTER OF FAMILY MEDICINE
No: 304/018
Data: 20.08.2018.
SKENDERAJ



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Drejtoria për Shëndetësi e Mirëqenje Sociale
Direkcija za Zdravstvo i Socijalno Blagostanje
Department of Health and Social Welfare

Glavni Centar za Porodicnu Medicinu
Br. 304/018
Skenderaj/Srbica, 20.08.2018 g.

Na osnovu odluke Predsenedika Opštine Skenderaj br. 02/111/01-0047305/18, od dana 20.08.2018 god., za odobrenje objavljivanje konkursa za slobodna radna mesta za dva (2) lekara opšte prakse, u okviru GCPM-a Skenderaj/Srbica i u skladu sa članom 7,8,10 i 10, stav 1, podstav 2.1, čla 15 stav 1,2 i 3 mZakona o Radu Republike Kosova br. 03/L-212, člana 14 stav, 1 Zakona o Zdravstvu u Republici Kosova br. 3/L-125, člana 4, Administrativnog Upustva (MRSB) br. 07/2017. za Regularizacije Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, Šef Administracije i Personalna GCPM-a, Skenderaj/Srbica, objavljuje sledeći:

KONKURS
ZA PRIJEM U RADNOM ODNOSU

I. Naziv radnog mesta: Lekar Medicine, dva (2) položaja:
- Kategorija stepen radnog mesta:
- Koeficientat 7.20, H-27;
- Radno vreme 40 časova nedeljno;
- Trajanje Ugovora u skladu sa Zakonom o Radu, 03/L-212.

Zadaci i odgovornosti:
Radne Zadatke i obaveze će se izvršiti u skladu sa opisom radnih zadataka i obaveza za Lekara, koja su predvidene prema Unutrašnjeg Pravilnika za Sistematizaciju i Organizovanje Radnih Mesta, kao i druge poslove od oblasti porodične medicine po naređenju šefa i direktora, kojima i raportira.

Uslovi konkursa:
Kandidati koji konkurišu za ova radna mesta osim opštih predvidenih uslova prema zakonu, trema imati završenu:
- Medicinski Fakultet – pravac opte medicine;
- Kandidat mora imati licencu za rad.

Potrebna dokumentacija:
- Kopiju Diploma Medicinskog Fakulteta;
- Kopiju Licence za Rad;
- Rodjeni izvod;
- Kopiju lične karte izdate od MUP-a Republike Kosova;
- Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom od nadležnog Suda
- Lekarsko Uverenje;
- Svaki drugi dokumentat od raznih trajninga, koju kandidat procenjuje važnom za ovo radno mesto.
- Dokaz za dobro poznavanje rad na računaru – poželjna.

Svaki aplikant mora predati svu traženu dokumentaciju:

- Popunjena Aplikacija,
- Dokaz o pripremi i stručnu kvalifikaciju – (overenu fotokopije) diplome.

Svih kandidati koji udu u užu listu, će se pozvati na intervju, i za datum održavanja internua biće na vreme obavesteni od strane određene Komisije za Intervju.


Aplikaciju se mogu dotibi prazne i popunjavaju i predaju se u Administraciju GCPM-a Skenderaj/Srbica od 8-15 časova.


Dokumentacija koja se priloži aplikaciji mora biti fotokopje i ista se ne vraća kandidatu.

Dokumentacija koja se ne odgovara uslove i kriterie konkursa, kao i nekompletirana dokumentacija i ona koja dolazi posle roka konkursa neće se razmatrati.

Rok za konkurisanje će biti petnaest (15) dana od dana objavljivanja konkursa u dnevnom novinu i drugim sredstvima informiranja.

Konkurs se objavlja u oba jezika.

G C P M Skenderaj/Srbica;
Rukovodilac personala i Administracije
Behram Mehaj dipl. pr.




>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► "GenKor - V" SH.P.K, Prishtinë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër fiskal 601631113 dhe NRB 71279251, si dhe me Nr. TVSh 330323650

► "Green Land" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71020479.

► Ardian Ahmeti i shpall të pavlefshëm certifikatën e TVSH me nr: 300342923 dhe certifikatën e biznesit me nr: 71346404

► Ajla Leskovi shpall të pavlefshme diplomën SHMM "Luciano Motroni" në Prizren

► Berat Gashi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHM e "Ymer Prizreni" në Prizren

► Sabedin Gashi shpall të pavlefshme diplomën SHM e "Ymer Prizreni" në Prizren

► Dashnije Rama shpall të pavlefshme dëftesat SHF "Mustafa Baku" në Prizren

► Alban Kajdomqaj shpall të pavlefshme diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" në Prizren

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Shëndetësisë
 Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
 Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division

NJOFTIM PËR VAZHDIM TË KONKURSIT

Ne bazë të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe në mbështetje të nenit 22 paragrafi 3 të kësaj rregulloreje vazhdon afati i konkursit edhe për 7 ditë, për konkursin e publikuar në gazetën ditore "Bota Sot" dhe "Epoka e Re" me datë 09/08/2018, si më poshtë:

1. Asistent Administrativ; Nr. Ref. MSh-24/08/18

Afati i vazhdimit të konkursit zgjatet edhe për shtatë (7) ditë, nga data 28/08/2018 deri më 03/09/2018.

OBAVEŠTENJE O PRODUŽENJU KONKURSA

U skladu sa Zakonom br. 03 / L-149 o civilnoj službi Kosova i Pravilnikom br. 02/2010 o proceduri regrutacije u civilnoj službi, u skladu sa članom 22 stav 3 ovog pravilnika „produžava se rok konkursa za još 7 dana za doleavedeni konkurs objavljen u dnevni novinama "Bota Sot" i "Epoka e Re" dana 15 maja 2018 godine:

1. Administrativni asistent; Br. Ref. MZ-24/08/18

Produženje konkursa važi za još sedam (7) dana, od 28/08/2018 do 03/09/2018.

Lume's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lume's Details
 lumesdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**AUTOSHKOLLA
 "RITMO - L"**



**Auto Shkolla
 "RITMO - L"
 Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
 - përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
 Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:
 044 248 173
 044 200 604
 044 375 333**



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/620

Më: 27.08.2018

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASIIT Nr.10/2018 datë: 20.07.2018. Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimin të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

Viti shkollor 2018/2019

| Nr. | Niveli, Shkolla | Pozita | Vendi i lirë/zëvendësim | Numri i pozitave | Orë |
|-----|--------------------------------------|-----------|--|------------------|-----|
| 1 | SHFMU" Vesel Pagarusha" në Pagarushë | Edukatore | Zëvendësim i lehonisë me kohë të caktuar | 1 | 20 |

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)
- Certifikata e lindjes

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Fakulteti i Edukimit -Programi Parashkollor; Shkolla e Lartë Pedagogjike-Drejtimi për Edukatore; Fakulteti Filozofik - Dega e pedagogjisë së përgjithshme, Fakulteti i Shkencave Sociale-Programi Përkujdesja dhe Mirëqenia e fëmijëve, këto kriteret janë përcaktuar sipas UA-iv të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018, datë 20.07.2018. Vetëm në mungesë të kandidatëve të kualifikuar nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet tjera.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

Për intervistë do të ftohën kandidatet, të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Lista e ngushtë e kandidatëve të cilët ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web-faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistës.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **28.08.2018 më datën:11.09.2018**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Emin Duraku"- Dragobil

Komuna: Malishevë

Data: 28.08.2018

Emri i kontratës: Kuize të ndryshme dhe Garat sportive.

Numri i kontratës: ESIP/SDG/051- ESIP/SDG/051-CS/1.3

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Emin Duraku"- Dragobil - Malishevë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

Kuize të ndryshme dhe Garat sportive

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën Shkollës "Emin Duraku"- Dragobil - Malishevë, më së largu deri më 05.09. 2018.

4. Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentët lutën që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Arianit Paçarizi, Isuf Ulluri

Telefoni: 049262493,049579871.

E-maili: pacarizarianit@gmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Ruzhdi Xhyliqi" Marali

Komuna: Malishevë

Data: 28.08.2018

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|--|---|
| ESIP/SDG/ESIP-C1. 3ESIP/SDG/055-CS/1.2 | Organizimi i garave sportive me shkollat fqinjë |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Ruzhdi Xhyliqi"- Marali-Malishevë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimit të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

- Organizimi i garave sportive me shkollat fqinjë në Marali

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën e shkollës "Ruzhdi Xhyliqi" Marali-Malishevë, më së largu deri më 05.09. 2018.

4. Termet e Reference së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentët lutën që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Labrije Hoxha, Bujar Kastrati

Telefoni: 044817639 & 049999935,

E-maili: shkolla_ruzhdixhyliqi@hotmail.com



ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)

- ★ N&C Refreshments Corporation- Antipolo *Philippines*, Quality
- ★ Emisintelladonna Central S.A *Paraguay*, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Nacionales Salvadoreñas S.A. *El Salvador*, Quality
- ★ Fibiak S.p.ka. *Kosovo*, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Fuzada Ltda *Brazil*, Quality
- ★ Interbrand S.J.L. *Lebanon*, Sales
- ★ Kořola ČeskoSlovensko a.s. *Czech Republic*, Quality
- ★ Obi Zetal CJSC *Tajikistan*, Quality
- ★ Parlex Sales sales Beverages Ltd. *Bangladesh*, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia *Georgia*, Sales

RC
cola

Coltănu, Cluj, România, 1994
— Since 1999 —